

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7590 E hënë 16 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

**Q**ë nga njoftimi për takimin mes presidentit amerikan Trump me presidentin rus Putin, ka ardhur në rritje interesimi për axhendën, problemet ...  
Vijon në faqen 21

Nga VASIL KURETA

Interesim i lartë dhe pak pritshmëri nga takimi Trump-Putin



Opinion **i** Ditës

**S**h shumë hulumtime interesante akademike janë duke u kryer në mediat digjitale, por a ka njerëz vullnetmirë për t'i lexuar gjithë këto revista shkencore? ...  
Vijon në faqen 21

Nga MONIKA STAFA

Të kontrollosh burimin: Studimet më interesante në median digjitale gjatë 2018



Policia: Vrasja me pagesë. Flasin fqinjët

## Kasaphanë në Shkodër, vritet me 23 plumba ish-polici dhe gruaja, shpëton fëmija 3 vjeç

Detajet e krimit makabër ku mbeti i vrarë çifti, nga përpjekjet e burrit për të mbrojtur gruan të lëvizja e të voglit...

Nga SENAD NIKSHIQI

Vrasja e ish-efektivit të policisë, Boran Bërcana dhe bashkëjetueses së tij ka tronditur familjarët e tyre. Nëna e 30-vjeçarit dhe vëllai i tij pasi kanë mësuar lajmin e koshëm kanë mbërritur në vendin e ngjarjes ...

Në faqen 2-3

## LISTA E PLOTE ME EMRAT E PERFITUESVE QE DOREZUAN DOSJET NE VITET 1999-2000

# KOMPENSIMI I PRONAVE, 2080 PRONARE QE MARRIN PARATE

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon dokumentet që duhet të dorëzojnë përfituesit dhe formulari për të marrë vlerën e paracaktuar



(Në foto) Toka (foto ilustruese)

Në faqen 9-11

REAGIMET E CEREMONIA



**Franca fiton Kupën "Rusi 2018", kroatët simpatinë e gjithë botës**

Në faqen 22

Mjeku popullor Ylli Merja, si të dobësoheni 4 kile për një muaj, dieta

## Mjekja Lekaj: Dhimbjet e gjoksit, shenjat që s'duhën neglizhuar

Profesor Edvin Prifti: Kirurgjia miniinvazive e zezës bëhet realitet

**D**himbjet e gjoksit mund të paralajmërojnë një sërë sëmundjesh, të cilat në rast se nuk kurohen në kohë mund të kenë pasoja të rënda shëndetësore. Mjekja Vlera Lekaj, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", shpjegon rastet që kërkojnë ndërhyrje të shpejtë dhe



rastet që mund të trajtohen me dieta ushqimore. Çfarë paralajmërojnë dhimbjet e gjoksit? Dhimbjet e gjoksit janë një problem i shpeshtë, i ndeshur në praktikën e përditshme klinike. Përfaqësojnë një simptomatologji komplekse në llojin ...

Suplement7

REAGJONET E PD

**Urdhri i Bashës: Baza, propozime në qendër për aksionin e ri politik që do të nisë në shtator**

Në faqen 5

FOTOT E KRYEMINISTRIT

**Siguria e qytetarëve, Rama: Kulla vrojtimi nga Velipoja në Sarandë, ndryshim si nata me ditën**

Në faqen 6

NGJARJA NE DIBER

**Rikthehen grabitjet me armë, plagoset tre plumba i riu teksa pikasi hajdutët**

Në faqen 7

FLET EKSPERTI

**Hasan Stafa: Në Shqipëri ka hyrë mish i kalbur dhe pula që duheshin asgjësuar, gjendja kritike**

Në faqen 8

## KASAPHANE NE SHKODER INTERVISTA

Gjendet makina e djegur e autorit dhe arma. Policia: Dyshime për vrasës me pagesë

# Ekzekutohen me 23 plumba automatiku në makinë ish-polici e bashkëjetuesja

*Shpëton mrekullisht fëmija 2-vjeçar i çiftit, u gjet në prehrin e nënës i mbuluar nga gjaku*

Senad Nikshiqi

SHKODËR

**T**ronditet Shkodra. Një ish-efektiv policie dhe bashkëjetuesja e tij janë ekzekutuar me breshëri automatiku brenda në makinë. Plot 23 plumba janë shkrëpura nga arma automatike "MP5" në drejtim të 30-vjeçarit Boran Bërcana dhe 25-vjeçarës Silvana Ndoci, duke i lënë të vdekur në vend. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Shkodrës bënë me dije se ngjarja e rëndë ka ndodhur pak pas mesnate në vendin e quajtur "Rruga e gjerë", në lagjen "Naim Gjylbegu" të këtij qyte. Mësohet se ish-polici dhe gruaja e tij u vranë poshtë pallatit ku jetonin me qira prej 8 muajsh, ndërkohë që trupat e tyre të pajetë e të bërë shoshë nga plumbat janë gjetur nga banorët e lagjes në fjalë dhe policia rreth orës 06:40 të mëngjesit të djeshëm. Boran Bërcana dhe Silvana Ndoci kanë qenë brenda makinës tip "Benz" me targë AA 006 HA, në momentin kur janë qëlluar nga ekzekutori. Brenda mjetit, në prehrin e nënës ndodhej edhe djali i mitur i çiftit. Për disa orë me radhë djali 2-vjeçar ka qëndruar brenda makinës derisa policia dhe ambulanca janë njoftuar nga një prej komshinjeve, i cili ka parë dy trupat e pajetë brenda makinës. Menjëherë në vendngjarje ka mbërritur ambulanca, e cila ka bërë të mundur transportimin e djalit të vogël drejt spitalit të Shkodrës dhe pas një kontrolli, atë e kanë marrë familjarët. Në vendin ku ndodhi krimi i dyfishtë kanë mbërritur efektivet blu bashkë me grupin hetimor dhe një prej prokurorëve dhe kanë nisur



Viktimat Boran Bërcana dhe Silvana Ndoci.



Djali 2-vjeçar i çiftit të vrarë

hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje. Sipas burimeve të mësipërme po punohet në disa pista. Dyshohet që vrasja mund të ketë ndodhur për shkak të detyrës që ka bërë Bërcana, por nuk përjashtohet mundësia që krimi të ketë ndodhur dhe pas ndonjë konfliktit të mundshëm mes ish-efektivit me persona të tjerë. Boran Bërcana ka qenë efektivi në policinë e Shkodrës, më pastek forcat "Shqiponja", pak kohë ka shërbyer në Pukë, është rikthyer në Shkodër. Ai

është larguar nga policia në janar të këtij viti, para se të niste procesin i vetingut.

### VRASJAS E DYFISHTË

Sipas hetuesve të çështjes, çifti në fjalë sapo kishin mbërritur poshtë pallatit ku jetonin prej 8 muajsh dhe në atë moment ende pa zbritur nga mjeti, ekzekutori i ka qëlluar me breshëri plumbash Boran Bërcanën dhe Silvana Ndoci. Ka qenë ora 01:15 e mëngjesit të djeshëm, kur autori ka qëlluar

### DJALI 2-VJEÇAR

Djali i mitur i çiftit, dyshohet se ka qenë në gjumë në sediljen e pasme të 'Benzit' kur ka ndodhur vrasja. Ndërsa, efektivet e policisë e kanë gjetur atë në prehrin e nënës të mbuluar nga gjaku. 3-vjeçari ka qëndruar për mbi 5 orë brenda makinës, pranë trupave të pajetë të prindërve. Fatmirësisht ai u mbijetoi plumbave

### MOTIVI I KRIMIT

Policia mendon se është një vrasje profesioniste, ndërsa nuk përjashtohet mundësia se mund të jetë me pagesë duke parë dinamikën e kësaj ngjarje dhe veprimet e autorit nga fillimi në fund. Ende janë të paqarta arsyet e vrasjes që tronditi banorët e Shkodrës, ndërsa mendohet për ndonjë konflikt të mundshëm të 30-vjeçarit me persona të tjerë.



qëlluar me breshëri në drejtim të çiftit duke mos lejuar Boran Bërcanën dhe Silvana Ndoci që të mos bëjnë asnjë lloj reagimi.

### HETIMI

Sapo është marrë njoftimi për gjetjen e makinës së djegur; aty ka mbërritur policia. Pas verifikimeve të para është arritur në konkluzionin se mjeti tip "Benz C Class" mund të jetë përdorur në vrasjen e dyfishtë të çiftit Bërcana-Ndoci. Autori pasi ka djegur mjetin në fjalë është dyshohet se është përdorur në këtë krimin makabër. Makina e djegur tip "Benz C Class" është gjetur e djegur rreth orës 10:30 në Dobrajë të Ri, në zonën e By Pass-it të Shkodrës që është në ndërtim e sipër. Burimet policore pohuan se autori pasi ka kryer vrasjen e Boran Bërcanës dhe Silvana Ndoci ka shkuar me mjetin tip "Benz C Class" deri tek By Passi duke qenë se aty nuk asnjë lëvizje gjatë natës dhe më pas i ka vënë flakën makinës për të humbur gjurmët e krimin. Ekspertiza pas këqyrjes të vendit të ngjarjes ka arritur të gjejë tek makina e djegur edhe armën, me të cilin dyshohet se është bërë vrasja. Sipas burimeve të mësipërme, bëhet fjalë për një armë automatike gjermane tip M5P me karikator që zë deri në 30 fishekë. Ajo dyshohet se është arma e krimin duke qenë se tek vendi ku ndodhi vrasja policia ka gjetur 23 gëzhoja dhe po ashtu mbetje plumbash të asaj arme. Autori ka

ar në drejtim të viktimit. Boran Bërcana, pasi ka parë personin me armë në dorë është hedhur në anën e partneres së tij për ta mbrojtur atë me trupin e tij, por ka qenë e pa mundur, sepse edhe ajo është qëlluar duke gjetur vdekjen. Djali i mitur i çiftit, dyshohet se ka qenë në gjumë në sediljen e pasme të 'Benzit' kur ka ndodhur vrasja. Ndërsa, efektivet e policisë e kanë gjetur në prehrin e nënës së tij të mbuluar nga gjaku. 2-vjeçari ka qëndruar për mbi 5 orë brenda makinës, pranë trupave të pajetë të prindërve. Pas këqyrjes së vendit të ngjarjes, policia ka gjetur 23 plumba që janë lëshuar në drejtim të çiftit. Fatmirësisht, fëmija i vogël ka shpëtuar pa marrë asnjë plumb. Po të njëjtat burime thanë se Boran Bërcana ka plumb në kokë dhe plumba të tjerë në gjithë trupin, po ashtu edhe bashkëjetuesja, Silvana Ndoci. Ende janë të paqarta arsyet e vrasjes që tronditi banorët e Shkodrës dhe jo vetëm, ndërsa mendohet për ndonjë konflikt të mundshëm të 30-vjeçarit me persona të tjerë. Policia po punon intensivisht për identifikimin dhe gjetjen e autorit të krimin. Trupat e pajetë, pas ekspertizës u transportuan me ambulancën





Vendi ku ndodhi vrasja e dyfishtë në rrethi makina ku u ekzekutua çifti

#### ARDI VELIU

Pas ngjarjes së rëndë, në Shkodër ka mbërritur drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ky i fundit ka shkuar në një takim në Drejtorinë Vendore të Policisë së Shkodrës ku është takuar me kreun e bluve, Vehbi Bushati dhe grupin hetimor që është marrë me detajet e vrasjes së Boran Bërcanës dhe Silvana Ndocit. Drejtori Veliu ka kërkuar angazhim maksimal për zbardhjen e plotë të vrasjes së dyfishtë.



## Boran Bërcana u largua nga policia para vetingut, ka qenë 2 muaj në Spanjë

SHKODËR - 30-vjeçari Boran Bërcana, i cili u ekzekutua në makinë së bashku me bashkëjetuesen e tij Silvana Ndoci ka qenë efektiv në policinë e Shkodrës, më pas tek forcat "Shqiponja". Për pak kohe ai ka shërbyer në Pukë dhe më pas është rikthyer sërish me detyrë në Shkodër. Bërcana është larguar nga Policia e Shtetit para pak muajsh (në janar të këtij viti) përpara se të niste procesin e vetingut. Burime për "Gazeta Shqiptare" dje bënë me dije se për afro dy muaj ka qëndruar në Spanjë, ndërsa 8 muajt e fundit jetonte tek pallati tek "Rruga e Gjanë" siç njihet në Shkodër. Mësohet se ai ka qenë i martuar me herë dhe se është divorcuar rreth 5 vite më parë, për t'u lidhur më pas me Silvi Ndocin, nga e cila kanë edhe një djalë 2-vjeçar. Pas vrasjes së dyfishtë, policia dhe prokuroria e Shkodrës janë duke hetuar intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorit (dysohet për një person) si dhe për zbardhjen e motivit të krimit.

Fqinjët e viktimave: Ishin njerëz të mirë, jemi shokuar nga vrasja makabër

# Nëna e ish-policit Boran Bërcana e shokuar: O Zot, ku e kam djalin?

Vëllai i viktimës merr nipin e mitur në spital

Senad Nikshiqi

#### SHKODËR

Vrasja e ish-efektivit të policisë, Boran Bërcana dhe bashkëjetueses së tij ka tronditur familjarët e tyre. Nëna e 30-vjeçarit dhe vëllai i tij pasi kanë mësuar lajmin e kobshëm kanë mbërritur në vendin e ngjarjes rreth orës 07:30. Mësohet se e ëma e viktimës ka tentuar që të shkojë tek makina ku ndodhej trupi i pajetë i djalit, por nuk është lejuar nga forcat e policisë. Ajo u dëgjua duke thënë: "O Zot ku e kam djalin, më raftë pika mua". Me lot në sy dhe e shokuar, nëna e ish-policit u largua nga aty. Ndërsa, vëllai i Boran Bërcanës u interesua për djalin e vogël, nipin e tij 3-vjeçar që ka qenë brenda në makinë kur ka ndodhur vrasja e prindërve të tij. Efektiviteti i kanë treguar se ndodhet në spitalin rajonal të Shkodrës. Menjëherë, familjarët kanë shkuar në spital dhe kanë marrë të miturin që u shpëtoi mrekullisht 23 plumbave. Ndërkaq, ngjarja e rëndë ka shokuar dhe fqinjët e viktimave. Ata u shprehën për "Gazeta Shqiptare" se Borani dhe gruaja e tij ishin njerëz të mirë dhe jo problematikë. Vjollca Teodori është tronditur kur ka mësuar se fqinjët e saj, Boran Bërcana dhe Silvana Ndoci u vranë poshtë pallatit. Teodori ka qenë e para kur ka kaluar në orën 5:30 të mëngjesit, por ajo nuk ka vënë re se çifti në fjalë ishte vrarë. Në një intervistë për "GSH", ajo tregoi se ka parë makinën e ndezur, por pa e kuptuar se çfarë kishte ndodhur.

Si e keni njohur Boran Bërcanën dhe Silvana Ndocin që u vranë poshtë pallatit tuaj?

Unë i kam njohur si njerëz shumë të mirë, qoftë atë djalin por edhe atë vajzën që u gjetën të vrarë. Kemi pasur komunikim të rregullt, dhe për ne kanë qenë shumë korrekt. Familje e rregullt dhe pa probleme, të paktën për aq sa i kemi njohur ne. Di që kanë edhe një fëmijë të vogël duke qenë se i shihnim bashkë shpesh.

A keni dëgjuar ndonjë zhurmë apo krismë armësh në momentin kur ka ndodhur ngjarja?



Nëna dhe vëllai i ish-policit të vrarë



Fqinja e viktimave, Vjollca Teodori duke folur për "GSH"

## Pronari i banesës, Nuri Vreto: Çifti ishin njerëz korrektë, më paguanin qiranë prej 8 muajsh

SHKODËR - Nuri Vreto është pronari i shtëpisë, në të cilën prej 8 muajsh çifti Boran Bërcana dhe Silvana Ndoci jetonin në lagjen "Naim Gjylbegu". Ai u shpreh dje për "GSH" se çifti në fjalë ishin të rregullt, ndërsa tregon se si është njohur me ta në momentin që kanë bërë marrëveshjen për dhënie me qira të shtëpisë. "Unë i kam lëshuar shtëpinë me qira çiftit që është vrarë sot (dje). Prej 8 muajsh ua kam dhënë shtëpinë, pasi kemi rënë dakord. Ata kanë paguar 170 mijë lekë të vjetër në muaj. Të paktën nga sa i kam njohur unë, kanë qenë shumë të rregullt. Paratë e qirasë i kam sjellë rregullisht dhe



Nuri Vreto duke folur për "GSH"

kjo ka qenë kryesorja për mua. Po ashtu kanë paguar në mënyrë të rregullt energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm. Këto më kanë interesuar më shumë se çdo gjë tjetër", tha Vreto. Ndërsa sqaroi se shtëpinë e kishin blerë në vitin 2009. "Në kontakt me këtë familje kam rënë rastësisht. Gratë kanë

qenë në një parukeri kur rastësisht gruaja e Boranit ka diskutuar për një shtëpi me qira dhe nga aty pastaj kemi marrë kontakt dhe kemi rënë dakord për çdo gjë. Nuk kam pasur shumë kontakte, por për aq sa kam pasur kanë qenë korrekt", u shpreh Nuri Vreto.

Jo të them të drejtën nuk kam dëgjuar asgjë. Unë kam qenë në gjumë dhe s'kam dëgjuar ndonjë zhurmë. Me sa di edhe komshinjtë e tjerë nuk e kanë dëgjuar zhurmë, se përndryshe do kishim reaguar.

Kur keni dalë nga banesa ju?

Unë kam dalë nga shtëpia ime herët në mëngjes. Kam dalë që në orën 05:30 dhe besoj kam qenë e para. Kam kaluar aty afër. Unë, në fakt, e kam parë makinën e ndezur, pra më drita të ndezura, por nuk e kam kuptuar fare se çfarë kishte ndodhur. Unë do kisha kaluar edhe herë të tjera dhe s'do e kisha vënë re atë që kishte ndodhur, sepse mendova se mos janë në shtëpi duke marrë me ndonjë gjë ose mos është ndonjëri në

makabre mund ta quaj. T'i vrasësh të dy në praninë e fëmijës së vogël është e tmerrshme. Të gjithë e kemi përjetuar shumë keq. Përveç çiftit, më dhimbset shumë djali i tyre i vogël. Kjo që ndodhi është shumë e rëndë për familjet e tyre. Nuk e di çfarë dore është ajo që ka bërë këtë vrasje.

Kanë sjellë ndonjë problem ose keni dijeni për ndonjë problem të tyrin që mund të kenë pasur gjatë muajve që jetonin këtu tek pallati juaj?

Jo nuk kanë pasur asnjë problem. Nuk kam asnjë lloj ideje, sepse sillleshin shumë mirë dhe ishin shumë korrekt me të gjithë ne. Nuk e di nëse kanë pasur probleme. Dukeshin të qetë dhe një familje krejt normale.

## STRATEGJIA OPOZITA

Strategjia e re e opozitës nis në shtator, kërkesat e aleatëve për Lulzim Bashën

# Shehi dhe Ndoka: PD, jo pazare me PS-në në kurrizin tonë

### "Ndryshim sistemi dhe lista të hapura"

Valentina Madani

Opozita pritet të rifillojë aksionin e saj politik në muajin shtator kundër qeverisë së kryeministrit Edi Rama. Por aleatët e Lulzim Bashës parashtrajnë një sërë kërkesash sipas tyre imediat në funksion të fitores së opozitës përballë mazhorancës sipas tyre të lidhur me krimin. Reforma zgjedhore do të jetë testi i radhës që Lulzim Basha do të duhet të kalojë në shtator për të kënaqur pritshmëritë e aleatëve të tij. Të prerë në kërkesat e tyre ata thanë për TVKlan se prioriteti i punës së komisionit të reformës zgjedhore duhet të jetë ndryshimi i sistemit elektoral dhe listat e hapura. Dashamir Shehi, kreu i LZHK-së flet për kërkesa konkrete: "Është e domosdoshme të ndryshohet sistemi, që mund të bëjë përgjdhje përtej flamurit politik, ose të bëhen lista të hapura, ose një pjesë e zonave të bëhen mazhoritarë, sepse deri më sot shqiptarët votojnë listën që u ofron kryetari". Ndërsa kreu i PDK, Nard Ndoka, u shpreh: "Kemi një sistem që zhvlerëson votën e shqiptarëve, është një kod zgjedhor antikushitetues, vota nuk ka peshë. Është imediat që ne të diskutojmë disa variante". Deputetët Shehi dhe Ndoka i sugjerojnë kreu të demokratëve të heqë dorë nga pazaret me Partinë Socialiste në kurriz të të vegjëlve. "PD mban të njëjtin mëkat me PS, e kanë njoollor sistemin tonë zgjedhor, por PD duhet të heqë dorë nga monopoli dhe kontrolli i zgjedhjeve me PS. Kjo është domosdoshmëri që PD ta bëjë këtë hap të guximshëm dhe për Bashën është e rëndësishme që edhe vetë është ndryshe nga politikanët që kemi parë më parë", shtoi Ndoka. Dashamir Shehi theksoi: "Ky do ishte revolucion i madh, do kthehe demokratë dhe do krijonte piramidën e vlerave, një elitë politike, sepse vota e popullit do tregonte sa vlen ky. Ndërsa sot elitën e partive e bëjnë kryetarët e partive dhe fatkeqësisht janë bërë një grup



Kreu i LZHK DASHAMIR SHEHI

#### DASHAMIR SHEHI

"Së pari, ne do të fillojmë luftën nga shtatori e mbrapa në fillim duke ndryshuar ligjin zgjedhor. Së dyti, duam të rikorigojmë të gjitha deformimet që i janë bërë sistemit gjyqësor. Prokuroria po rri. E treta, ato institucione që duhet të kontrollojnë sistemin e drejtësisë, edhe ata mund të rishikohen", tha kreu i LZHK-së.

#### "Përgjegjësi të rënda për përfshirje në krim"

Vasili: "Forca e ligjit" si farsë, pse s'janë arrestuar shefat e policisë së drogës

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili, akuzon Ministrinë e Brendshme për mënyrën si po zbatohet operacioni "Forca e ligjit. Ai shprehet se ky aksion është një farsë, duke shtruar pyetjen se pse nuk janë arrestuar ende shefat e policisë së drogës së Vlorës. "Forca e ligjit" si farsë, pse shefat e policisë së drogës së Vlorës nuk janë arrestuar akoma? Shefat e policisë që drejtonin dhe mbështesnin trafikun e kultivimit e drogës për të cilët u shpall arresti dhe burgimi në mungesë nuk janë arrestuar akoma. Kanë kaluar 9 muaj dhe shefat e policisë së Vlorës mbi të cilët rendojnë përgjegjësi të rënda për përfshirje në veprimtari kriminale janë të lirë. Po pse Ministria e Brendshme nuk flet dhe nuk informon fare për ta, nga çfarë trembet?

A mos ia kambyllur gojën Ministrisë së Brendshme



#### AKUZA

"Sido që të jetë ata do të arrestohen dhe atëherë opinioni do të marrë të gjitha përgjigjet për këto pyetje dhe arsyet e frikës dhe të heshtjes, por... atëherë gjithçka do të jetë shumë e rëndë për kryeministrin dhe ndëshkimi akoma më i rëndë. E shumta iku dhe shumë pak ka mbetur. Për fat të mirë ca gjëra... nuk i ka në dorë kryeministri, por ca të tjerë... jashtë Shqipërisë".

fakti se ata drejtonin në atë zonë veprimet që lidhet ngushtë me ish-ministrin e Brendshëm dhe akuzat që ren-

dojnë ndaj tij? A është pakti i heshtjes për këta, një pikë e kompromisit dhe shantazhit reciprok mes kryeministrit

servilësh që produktivitetin e tyre e tregon kjo politikë". Në funksion të një procesi zgjedhor që ofron garanci dhe standarde, aleatët e djathtë shohin edhe depolitizimin e komisioneve zgjedhore. "Për ne

është shumë i rëndësishëm edhe drejtimi i zgjedhjeve, jo me militantë partiakë, por me një trupë zgjedhore të depolitizuar. Ka sot me mijëra njerëz që mund ta kryejnë më mirë se politikanët e partive",

vijoi më tej kreu i PDK. "Kam njëzet vjet që e mbështes këtë ide. Sot me këtë trysni që ka politika, që është futur në xhepat e shqiptarëve, e vetmja mënyrë është që të votojmë elektron-



#### NARD NDOKA

"PD mban të njëjtin mëkat me PS, e kanë njoollor sistemin tonë zgjedhor, por PD duhet të heqë dorë nga monopoli dhe kontrolli i zgjedhjeve me PS. Kjo është domosdoshmëri që PD ta bëjë këtë hap të guximshëm dhe për Bashën është e rëndësishme që edhe vetë është ndryshe nga politikanët që kemi parë më parë," tha kreu i PDK.

#### SHKURT



#### Pampuri takon ish-kandidatin për president të SHBA

Deputetja e Partisë Demokratike Orjola Pampuri postoi një faqen e saj në Facebook një foto me ish-kandidatin republikan për zgjedhjet presidenciale në SHBA. Kënaqësi të takojta në Paris, Newt Gingrich, një prej ish-kandidateve republikane për president në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushatën e vitit 2012. - në Paris, Francë.

dhe ministrit aktual të brendshëm? ". shprehet z.Vasili. Ai shtron më tej pyetjen: "Po ata diplomatë të huaj që flasin me zell për "sukseset" imagjinare të luftës me drogën pse nuk flasin kurrë për këtë çështje me kaq rëndësi dhe që lidhet ngushtë edhe me ish-ministrin e Brendshëm? Po Kryeministri, që flet pa u lodhur, goja edhe me detaje për "sukseset" në luftën ndaj drogës pse nuk flet për ta? Çfarë dinë shefat në arrati që e shqetëson... kaq shumë kryeministrin dhe ai hesht? A mos është një mesazh edhe për shefat aktual të policisë, që "punoni drogën për ne se çfarëdo do që të ndodhë do t'ju mbrojmë prapëne?". Sipas Vasilit: "Sido që të jetë ata do të arrestohen dhe atëherë opinioni do të marrë të gjitha përgjigjet për këto pyetje dhe arsyet e frikës dhe të heshtjes, por... atëherë gjithçka do të jetë shumë e rëndë për kryeministrin dhe ndëshkimi akoma më i rëndë. E shumta iku dhe shumë pak ka mbetur. Për fat të mirë ca gjëra... nuk i ka në dorë kryeministri, por ca të tjerë... jashtë Shqipërisë".

ikisht, më pas edhe me depolitizim dhe komisione partiake, të rrinë si vëzhgues nga jashtë", u shpreh deputeti Shehi. Edhe ekspertët e zgjedhjeve e shohin të mundur depolitizimin e komisioneve zgjed-

hore, nëse partitë politike kanë vullnet për ta reflektuar një ndryshim të tillë në Kodin e ri Zgjedhor. Madje sipas tyre, kjo nisim mund të aplikohet edhe në zgjedhjet e ardhshme lokale.





PD reagime të forta kundër mazhorancës, Paloka: Në shtator, realiteti i ri politik

# Urdhëri i Bashës: Baza, propozime në qendër për aksionin e ri politik

PD shtyn për në vjeshtë zgjedhjet e brendshme

Valentina Madani

**K**reu i PD-së Lulzim Basha përmes një udhëzimi të brendshëm i kërkon bazës së partisë që të bëjë propozime se si duhet të ndërtohet aksioni i ri politik i opozitës, i cili pritet të rinisë në muajin shtator kundër qeverisë "Rama". Në shërbim të kësaj, Basha ka shpërndarë të deleguarit nga qendra drejt bazës me qellim marrjen e propozimeve të strukturave të partisë për strategjinë e re të opozitës. Kjo vjen në një kohë kur me datën 30 qershor duhej të ishin mbyllur zgjedhjet brenda PD-së, por ato do të shtyhen për në vjeshtë. Ndaj krerët aktual të degëve lokale të Partisë Demokratike, në vend të takimeve për zgjedhjet të cilat janë shtyrë për në shtator, po zhvillojnë takime me strukturat për vazhdimin e aksionit politikë ku shqyrtohen ngjarjet politike dhe propozohen ide për vijim e aksionit opozitar. Zgjedhjet e brendshme janë shtyrë për muajt e vjeshtës, ndërsa angazhimi kryesor i selisë qendrore, por dhe i drejtuesve lokalë do të fokusohet në denoncimet dhe çështja e Teatrit Kombëtar. Nënkrerëtar i Partisë Demokratike Edi Paloka, ka paralajmëruar një aksion të fortë opozitar kundër qeverisë për të bërë të mundur deri në shtator tha ai krijimin e një realiteti të ri politik. Paloka nuk specifikon mjetet që do përdoren në këtë aksion opozitar, por shprehet se shqiptarët tashmë nuk mund të durojnë një qeveri të lidhur me krimin. Në lidhje me ristrukturimin e PD, Paloka tha se procesi është shtyrë në shtator. Opozita paralajmëron reagime të forta kundër mazhorancës, të cilat sipas ekspertëve realiteti të saj do të ndryshojnë realitetin politik në vend. Nënkrerëtar i demokratëve Edi Paloka, nuk specifikon mjetet që do përdoren, duke theksuar se i gjithë aksioni është në diskutim. Kryetari i PD, Lulzim Basha udhëzoi në 11 maj nisjen e procesit për riorganizimin në degë, proces që duhej të mbyllej me 30 qershor. Por PD në plan të parë vendosi çështjet politike që lidheshin me akuzat ndaj qeverisë si çështja Xhafaj, me pas



Kryetari i PD Lulzim Basha

**SHTYRJA**  
"Rëndësi ka që në të kemi një procedurë zgjedhore dhe një proces zgjedhor brenda PD të mirëqenë, jo sa për të thënë, sepse në këtë periudhë duhet ta pranohet që jo të gjithë janë të impenjuar në këtë fushatë në këtë proces zgjedhor kështu që është parë më e arsyeshme që procesi të vijojë në shtator", thekson z.Paloka.



"Detyrim i çdo force politike të përgjegjshme"

## Emërimet e magistratëve, Balla apelon opozitën t'i votojë

**K**uvendi mbledhet sot ndërkohë që kreu i Grupit Parlamentar të PS, Taulant Balla apeloj për votimin e ligjit për magistratët e rinj, i shtyrë për shkak të mungesës së votave në seancën e kaluar. Në një intervistë pas përfundimit të samitit të parlamenteve të Europës Qendrore dhe Lindore, Balla tha se është detyrim i palëve politike për të vazhduar me zbatimin e reformës në drejtësi. "Bëhet fjalë për një detyrim të qartë të çdo force politike të përgjegjshme, sikurse bashkë kemi miratuar paketën e reformës në drejtësi dy vite më parë", tha z.Balla.

**THIRRJA**  
"Bëhet fjalë për një detyrim të qartë të çdo force politike të përgjegjshme, sikurse bashkë kemi miratuar paketën e reformës në drejtësi dy vite më parë", tha z.Balla.

Bëhet fjalë për një detyrim të qartë të çdo force politike të përgjegjshme, sikurse bashkë kemi miratuar paketën e reformës në drejtësi dy vite më parë, kështu na duhet edhe tani të rivendosim këtë afat me qëllim që djem e vajza të shkëlqyer që mbarojnë studimet në drejtësi dhe që duan që karrierën ta vijojnë duke u përfshirë në sistemin e ri të drejtësisë përmes kalimit të shkollës së magistraturës", u shpreh ai. Balla vlerësoi procesin e vetingut në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku evidentoi rastet e atyre që janë larguar nga sistemi. "Çdo ditë shohim përmes mediave sesi gjyqtarë apo prokurorë humbin të drejtën për të vazhduar për të qenë pjesë e sistemit. Ky është një hap i rëndësishëm, askush prej nesh nuk do ta kishte imagjinuar që paska qenë kaq e thellë dhe kaq e rëndë situata e korrupsionit në sistemin e drejtësisë", theksoi z.Balla. Opozita është shprehur e vendosur për të mos votuar ligjin për magistratët e rinj duke hedhur poshtë çdo aludim se ka pasur bisedime mes PS dhe LSI për të siguruar votat e nevojshme. Në seancën e kaluar PD dhe LSI nuk morën pjesë.

## Deputeti i PD: Nuk është veting, por banditing

### Dënimi i Roshit, Bylykbashi: Doli i buzëqeshur, triumfoi mbi drejtësinë

**D**eputeti i Partisë Demokratike, Oerd Bylykbashi komentoi dje vendimin e gjykatës ndaj ish-kryebashkiakut të Kavajës, Elvis Rroshi, që sipas tij ka rrezuar një prej mekanizmeve kryesore të ligjit për dekriminalizimin: falsifikimin e formularit, që duhej të dënohej me burg. "Kjo është një ftesë për kriminelët, që ligji i dekriminalizimit të mos i penalizojë e të ndihet të paprekshëm dhe të mbrojtur nga Rama", shprehet Bylykbashi. Deputeti demokrat përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", shkruan se Rroshi u dënua me një dënim të "tmerrshëm" edhe pse u provua që ka falsifikuar formularin shtetëror dhe për këtë

dënim shkon deri me burg. Deputeti demokrat reagon më i ashpër në lidhje me vetingun, duke shkruar deri aty sa ta quajë "banditing". "Në këtë Drejtësinë e reformuar me mbikëqyrje nga ORMN (Oficina e Riparimit të Mjeteve të Ndërtimit?), vetingu ka bërë që ikën gjyqtari që ka dhënë dënim me burg për kriminelë, por ai që ka përdhunuar në komunitet dënohet me 'punë në komunitet', praliteti i lirë. Fati i banditit dhe gjyqtarit bashkohet, ndahen dhe përcaktohen në psikikën që nuk fal të Edi Ramës?. Unë nuk e kam lexuar, por nuk është çudi, që gjyqtarin ta ketë përmendur me emër të 'Kurbani'. Një pyetje kam: nëse gjyqtari do të ishte parë në shoqërinë e Elvis

Rroshit, siç qëndron Rama, a do të përbënte kusht skualifikimi në sytë e këtyre nëpunësve të vetingut? Po çfarë veting thoni, ky është banditing!". Disa ditë më parë Gjykata e Shkallës së Parë dënoi ish-kryebashkiakun e Kavajës Elvis Rroshi me 7 muaj e 15 ditë burg, për shkak se përfitoi nga gjykimi i shkurtuar, dënim i ul në 5 muaj, po duke pasur parasysh që kishte qëndruar katër muaj në "arrest shtëpie", masa e dënim-it që mbeti për të vuajtur ishte vetëm 1 muaj burgim dhe në fund dënim i pezullua duke u konvertuar në 60 orë punë publike të detyruar. Elvis Rroshi u akuzua për falsifikim të formularit të dekriminalizimit.

çështja e teatrit të ri, duke lënë pezull ristrukturimin. Zyrtarisht zgjedhjet tashmë janë shtyrë në shtator. "Rëndësi ka që në të kemi një procedurë zgjedhore dhe një proces zgjedhor brenda PD të mirëqenë, jo sa për të thënë, sepse në këtë periudhë duhet ta pranohet që jo të gjithë janë të impenjuar në këtë fushatë në këtë proces zgjedhor kështu që është parë më e ar-

syshme që procesi të vijojë në shtator", thekson z.Paloka. Me ndryshimet në statut më 28 prill selia në qendër urdhëroi nisjen e zgjedhjeve në degët vendore të Partisë Demokratike, proces që parashikohet të mbyllet brenda muajit qershor, që më pas i haptë rrugë zgjedhjeve në qendër. Në fillim të muajit maj selia qendrore e Partisë Demokratike shpërndau një urdhër që

mbante firmën e kryedemokratit Basha dhe sekretarit të përgjithshëm, Arben Ristani që urdhëronte nisjen e procesit zgjedhor në dy nivelet të organizimit të degëve vendore të PD, në sekcione dhe grupseksione. Fillimisht, procesi zgjedhor parashikohet të zhvillohet për nivelin e grupseksionit dhe të seksionit, sipas parimit "një anëtar, një votë".

## QEVERISJA PROJEKTET

"Ka defekte dhe boshllëqe", kryeministri publikon fotot e kullave në plazhe

# Siguria e qytetarëve, Rama: Kulla vrojtimi nga Velipoja në Sarandë

"Ndryshimi si nata me ditën me vitet e shkuara"

Kryeministri Edi Rama njoftoi dje se për herë të parë në plazhet shqiptare është ngritur një infrastrukturë kullash vrojtimi në funksion të sigurisë së pushuesve. Me anë të një postimi në rrjetet sociale, kreu i qeverisë bëri të ditur se kjo infrastrukturë, megjithëse ende jo perfekte dhe pa boshllëqe, është si dita me natën me vitet e shkuara dhe në përmirësim ditë pas dite. Kryeministri Edi Rama me anë të disa fotove tregon se në plazhet e Shqipërisë ka një infrastrukturë të plotë të kullave të vrojtimit. Sipas tij ende nuk është perfekte dhe ka boshllëqe, por është si dita me natën me vitet e shkuara. "Për herë të parë ka një infrastrukturë kullash vrojtimi në funksion të sigurisë së pushuesve nga Velipoja në Sarandë. Ende jo perfekte dhe pa boshllëqe, po si dita me natën me vitet e shkuara dhe në përmirësim ditë pas dite, me gjithë dobësitë e mëdha të pushtetit vendor në këtë drejtim, edhe pse ky aspekt është detyrë ligjore e funksionit bashkive. Sidoqoftë asnjë justifikim dhe bashkëpunimi me bashkitë për të garantuar një sezon të pastër e të sigurt po forcohet dita-ditës në terren", shprehet z.Rama. Një tjetër projekt ishte ai i dy ditëve më parë kur kryeministri Edi Rama njoftoi nisjen e projektit që do të transformojë Tepelenën. Projekti, sipas tij, do të zgjidhë përfundimisht një nyje të mbetur rrugëve të aksit kombëtar Fier-Tepelenë-Gjirokastrë-Kakavijë. Shefi i qeverisë kishte një përgjigje edhe për ata që e kanë kritikuar se projektet janë vetëm në 3D. Me afro 2.9 miliardë Lekë do të ndërtohet bypasi i Tepelenës. Punimet për këtë nyje strategjike nisën këtë fundjavë dhe kryeministri Edi Rama deklaroi se nuk do të ndalen deri në realizimin e saj pas 24 muajsh siparashikon projekti. "Çelimi i kësaj strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të Tepelenës, e cila sig mund ta dëshmojnë



Kryeministri Edi Rama

të gjithë banorët është në një proces transformim rrënjësor dhe është në rrugën e kthimit të potencialeve të jashtëzakonshme pas dekadash harrese. Sot ne çelim kantonin për bypasin e Tepelenës, një veprë e përfolur për dekada të tëra dhe pjesë

e historisë së trishtueshme të bypaseve, e cila mjafton për të ilustruar më së miri se sa shumë kohë dhe energji si dhe para janë humbur më kot, për vite e vite të tëra në përpjekjen e dështuar për të ndërtuar bypasin. Projekti i financuar nga Autoriteti

Rrugor Shqiptar do të prekë dhe një nga monumentet historike që rrezikonte degradimin, Kalanë e Ali Pashës. Vepra të tjera infrastrukturorë që Rama premtim të fillojnë brenda mandatit janë 3 aeroportet i Vlorës, Kukësit dhe ai turistik i Sarandës.

**PROJEKTI**  
"Për herë të parë ka një infrastrukturë kullash vrojtimi në funksion të sigurisë së pushuesve nga Velipoja në Sarandë. Ende jo perfekte dhe pa boshllëqe, po si dita me natën me vitet e shkuara dhe në përmirësim ditë pas dite, me gjithë dobësitë e mëdha të pushtetit vendor në këtë drejtim, edhe pse ky aspekt është detyrë ligjore e funksionit bashkive", tha z.Rama.



Foto e kullave të vrojtimit

## Ambasada turke në Tiranë përkuajton 2-vjetorin e grushtit të shtetit

Dy vite nga 'grushti i shtetit' në Turqi, dje në Tiranë u mbajt një program me rastin e dy vjetorit të këtij grushti të dështuar, të orkestruar sipas autoriteteve turke nga pjesëtarët e organizatës terroriste FETO. Aktiviteti i organizuar nga Ambasadori turk në Tiranë, Murat Ahmet Yörük, vijoi pasi të pranishmin ndoqën disa pamje nga momentet e fokusuara me 15 korrik të vitit 2016 nga ku të pranishëm ishin dhe protagonistët të saj. Protagonistët e ngjarjeve thanë se edhe pse janë falënderuar si heronj, heronjtë e vërtetë janë ata që humbën jetën ato ngjarje. Sipas ambasadorit turk, përpjekja e grushtit të shtetit ishte faza e fundit e anëtarëve të organizatës terroriste FETO për të marrë kontrollin në Turqi. Në Turqi po zhvillohen 288 seanca gjyqësore në lidhje me përpjekjen e dështuar të grushtit të shtetit. Prej tyre, 56 zhvillohen në Ankara, 53 në Stamboll dhe 179 të tjera në qytete të ndryshme turke. Në 15 korrik, si pasojë e tentativës së grushtit të shtetit 251 policë, ushtarakë dhe civilë ranë dëshmorë dhe më shumë se 2000 të tjerë u plagosën.

## Stërvitje me komandot, "Ushtarak për një javë"

### FA hapin dyert për të rinjtë, Xhaçka: Mundësi për profesionistë të mirë

Forcat e Armatosura hapin dyert për të rinjtë e shkollave të mesme që ditët e verës t'i kalojnë pranë repartëve ushtarake për të parë nga afër dhe për t'u bërë pjesë e përditshmërisë së burrave dhe grave në uniformë. Grupi i parë i të rinjve u mirëpritën në mjediset e garnizonit të Forcës Tokësore në Zall - Herr ku përgjatë një jave u bënë pjesë e Forcave të Armatosura në kuadër të misionit të posaçëm "Rini - Talent - Mundësi - Dinjitet". Ministria e Mbrojtjes përgëzoi të rinjtë për pjesëmarrjen në këtë aktivitet 1-javor, duke i ftuar ata të marrin në konsideratë të ardhmen në

**NISMA**

Një shkollë verore që të bën të përjetosh ndjesinë e të qenit ushtarak i vërtetë. Kjo është nisma e Ministrisë së Mbrojtjes që synon të joshë maturantët që të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura. Për një javë gjimnazistët kanë veshur këmbalet e ushtarakut, dhe janë bërë pjesë e përditshmërisë së burrave dhe grave në uniformë.

Forcat e Armatosura. "Ne kemi pothuajse 300 vetë që punojnë në shtabet e NATO-s dhe në organizatat e tjera të Sigurisë dhe Paqes me të cilat ne bashkëpunojmë në të gjithë botën. Kemi atashë ushtarak në 10 vende të NATO-s, kemi njerëz jashtëzakonisht shumë që punojnë jashtë kufijve të vendit tonë,

sigurisht duke përfaqësuar Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Është një karrierë që të jep mundësinë që të rritesh dhe të përparosh mjafton që të duash të ecësh përpara." - u shpreh ministria Xhaçka. Ai përmendi mundësitë që ofrojnë Forcat e Armatosura për çdo profesion. "Një profesionist i mirë nuk është



vetëm një ushtar i mirë, një profesionist i mirë mund të jetë nga një efektiv xhenio, mund të jesh edhe një jurist shumë i mirë në FA, mund të

jesh edhe një ekonomist shumë i mirë në FA, mund të jesh edhe një financier shumë i mirë në FA, mund të jesh një mjek shumë i mirë, mund të jesh një infermier, mund të jesh gjithçka. Dhe kam përshtypjen dhe këtë e dëshmon çdokush që e ka një formim ushtarak, disiplina që përfitohet në ushtri është ajo që i duhet gjithkujt për ta pasur si çelës sukses në jetë", deklaroi ministria e mbrojtjes. Grupi i parë i të rinjve u vu nën drejtimin e instruktorëve të Forcave Komando dhe Forcave Speciale, ku u bënë pjesë e stërvitjeve bazë të dy repartëve elitë të Forcave të Armatosura.

Shitje me Ankad të Pare nga Studio Perbarimorë L.D.C

-Apartamenti me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar per shitje eshte 6.413.792 Lekë.  
Data e shpalljes 27.06.2018  
Data e zhvillimit 20.07.2018 deri ne oren 16.00  
Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Perbarimorë L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.



Arsen Selishta jashtë rrezikut për jetën, autorët në kërkim

# Rikthehen grabitjet me armë, plagoset me tre plumba i riu

## Ngjarja në Dibër në shtëpinë e Selishtëve

Rikthehen grabitjet me armë zjarri në Shqipëri. Një i ri nga Dibra është plagosur me tre plumba ndërsa hajdutët sulmuan shtëpinë e tij. Ngjarja ndodhi mëngjesin e së dielës në shtëpinë e Selishtëve, ndërsa Arseni djali i familjes ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

### NGJARJA

Ka qenë ora rreth 4.00 e mëngjesit të së dielës kur grabitës me armë ende të paidentifikuar kanë hyrë në banesën e shtetasit Adraman Selishta me qëllim për të vjedhur. Pasi ka ndërjer zhurmat, i biri i të zotit të shtëpisë, Arseni është përleshur me grabitësit, të cilët shtinë në drejtim të tij, ndërsa i riu mori tre plumba. Familjarët janë zgjuar nga krismat e armëve, por nuk kanë mundur të shohin grabitësit, të cilët u larguan menjëherë, ndërsa transportuan në spital birin e tyre. Sipas mjekëve Arseni është jashtë rrezikut për jetën, ndërsa pritet përmirësimi fizik i tij që policia t'i marrë dëshminë dhe mbase të vërë në shënjestër grabitësit, të cilët ende nuk dihet në ishin të maskuar apo jo. Familjarët kanë denoncuar ngjarjen në polici dhe një grup hetimor është ngritur për rastin. Policia ka shkuar në vendin e ngjarjes ku ka mbledhur të gjitha provat dhe po punon për identifikimin e autorëve dhe zbardhjen e plotë të krim-it.

### GRABITJET ME ARMË

Vetëm para pak muajsh në Kamzë mbeti i vrarë pas një grabitje me armë pronari i një minimarketi,



ndërsa gruaja e tij u plagos. Ngjarja ndodhi në rrugën "OSBE" ndërsa dy të rinj me një makinë kërkuan lekët e xhiros të dyqanit të vogël. Pas refuzimit nga pronarët, të cilët mbanin frymën gjallë me atë biznes të vogël autorët qëlluan duke lënë të vdekur Agim Buçin 52 vjeç babain e dy fëmijëve dhe

gruan e tij Merita Buçi 44 vjeç. Për ngjarjen u arrestuan dy autorët. Ndërsa në fillim të vitit 2018 një ngjarje po kaq e rëndë tronditi Fierin. Grabitës me armë u futën në një Exchange apo vend ku këmben valutat duke kërcënuar me armë pronarin. Agur Vrenozi, i cili pa ngjarjen tentoi të mby-

llte derën e biznesit për të izoluar vrasësit deri në momentin e mbërritjen së policisë, por ata e qëlluan me plumb në kokë. Vrenozi u quajt hero nga banorët e Fierit, ndërsa pronari i dyqanit Gëzim Hoxha, 64-vjeç, mbeti i plagosur. Autorët e ngjarjes u vunë në pranga pak orë më pas.

### SHKURT

#### Grabitën një karburant në Kurbin një vit më parë, pranga dy të dyshuarve

**KURBIN** - Një grabitje me armë zjarri e ndodhur një vit më parë, është zbardhur tashmë nga policia e Kurbin. Bëhet fjalë për vjedhjen me armë të një karburanti në 28 korrik 2017. Pas një hetimi me metoda proaktive nga Policia e Kurbin dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin në kuadër të operacionit të koduar "Skuraj", është zbardhur edhe një tjetër tentativë e vjedhjes me armë të një karburanti tjetër datë 28 shkurt 2018. Sakaq, janë vënë në pranga dy të dyshuar si autorë të ngjarjes, ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim. Si autorë të dyshuar të këtyre rasteve, janë identifikuar shtetasit: Flakon Tafa, 24 vjeç, banues në Kurbin (i dënuar më parë) dhe Faqjon Tafa, 27 vjeç, banues në Kurbin (i dënuar më parë) të cilët janë arrestuar në flagrancë. Si dhe është shpallur në kërkim dhe pënohet për kapjen e shtetasit F.K., 30 vjeç, banues në Kurbin (i dënuar më parë). Për të tre shtetasit e lartpërmendur, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka caktuar me vendimin datë 12.07.2018, masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprat penale "Vjedhje me armë e kryer në bashkëpunim" parashikuar nga neni 140-25 të Kodit Penal.

Vazhdon puna hetimore për dokumentimin ligjor të rasteve të tjera të vjedhjeve ku dyshohet se këta shtetas janë autorë.

#### Gjendet trupi i dekompozuar i 40-vjeçarës në kabinën e dushit, ku dyshon policia

**POGRADEC** - Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e djeshme në qytetin e Pogradecit, ku është gjetur trupi i pajetë i një 40-vjeçare, e cila jetonte e vetme në banesë. Mësohet se trupi i 40-vjeçares B.B është gjetur i dekompozuar, brenda në kabinën e dushit. Nga ekspertiza paraprake mjeko-ligjore, dyshohet se vdekja mund të jetë shkaktuar, si pasojë e kontaktit të viktimit me rrymën elektrike gjatë bërjes së dushit. Sipas informacioneve nga policia, dera e banesës ka qenë e mbyllur dhe vdekja mund të jetë shkaktuar nga rryma elektrike. Policia njoftoi se më datë 14.07.2018, rreth orës 22:10, në lagjen nr. 1, në banesën e saj ku jetonte e vetme, në kabinën e dushit, u gjet i dekompozuar trupi i shtetasës B.B, rreth 40 vjeçe. Nga ekspertiza paraprake mjeko-ligjore, dyshohet se vdekja mund të jetë shkaktuar, si pasojë e kontaktit të viktimit me rrymën elektrike gjatë bërjes së dushit. Grupi hetimor po punon për të zbardhur rrethanat e ngjarjes.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INTERVISTA/ Flet eksperti: Të rrezikuar nga ushqimet që na ofrohen 3

# "Në Shqipëri ka hyrë mish i kalbur dhe pula që duheshin asgjësuar"

## Hasan Stafa: Shfaqet plasja, 80% e bagëtive pa kontroll

Erjon Skëndaj

TIRANË

Fakte dhe dëshmi të frikshme për gjithçka konsumojmë dhe hamë, që nga qumështi deri tek mishi. Ato që dikur i hamendësonim i pranon vetë Kreu i Kontrollit të Zyrës së Mbrojtjes së Konsumatorit, Hasan Stafa në një intervistë për "BalkanWeb" me gazetarin Erjon Skëndaj.

Në vendin tonë deri një vit e gjysmë më parë kanë hyrë shpendë, kryesisht pula që duheshin gropsur në vendin fqinjë Greqinë, por që pseudo tregtarë i kanë marrë e shitur këtu si të ishin të freskëta. Stafa foli edhe për 7 ngarkesa me mish pa cilësi, "të kalbur" që ka hyrë në Shqipëri, prej të cilave janë kapur vetëm dy të tilla.

E si të mos mjaftonte kjo, shqiptarët vijnë në konsumojnë mish dhe nënproduktet e qumështit nga bagëti të pavaksinuar, të paregjistruara. Pikërisht në zonat e thella të Dibrës dhe Matit ku flitet së fundmi për shfaqjen e sëmundjes së plasjes, Stafa tha se 80% e bagëtive janë të paregjistruara. Sa për qumështin më aflatoksinë, ai u shpreh se i gjithë skandal i për të cilin folën mediat erdhi pas veprimeve të disa segmenteve të caktuara për të dëmtuar konkurrencën e ndershme.

**Pra, u bë qëllimisht thoni ju?**

Jo se nuk ka më probleme me aflatoksinë, por problemi është tek të gjithë. Nëse i bëjmë sot analizat problematike është Gjirokastra dhe Mati. Të mos harrojmë që ende nuk janë zhdurur gjurmët e dermatozës nodulare.

**Por thuhet se u mbyll çështja?**

Si u mbyll? Nuk ka asnjë raport, nëse ishin 50 krerë të prekura ku u konfiskuan, ku u bë groposja? Ku shkuan kafshët e prekura nga sëmundja? Ku u groposën? A ka mbetur ende gjurmë? Është ende rreziku i plasjes, apo antraksi.

**Kemi informacion për plasjen?**

Sot për sot gjurmët të çojnë në zonën e Dibrës, Matit deri në kufi me Laçin dhe Kurbinin. Atje janë 80 e krerëve të paregjistruara dhe të pamatrualluara, do të thotë nuk ka një evidencë kombëtare shërbimi bujqësor i këtyre zonave.

**Çfarë është bërë në 27 vite?**



Hasan Stafa

Unë ia kam thënë edhe ministrit Panariti problemet me vaksinat. Vaksinat bëhen në tri vende afër zonave të banuara. Mbetet i gjithë territori i Dibrës që është nga Kalaja e Dodës, në Reç. Nga një mosveprim i qëllimshëm rrezikohen

konsumatorët.

**Çfarë po bëhet me antraksin?**

Pasi u përhap lajmi i iu kanë dhënë porosi veterinerëve të shkojnë në këto zona, rrezik ka që mund të përhapet.

**E keni bërë të qartë in-**

**stitucioneve përkatëse problematikën?**

Jemi në fazën e dyshimeve, po mbledhim informacionin paraprak. Ka zona të dyshuara nuk ka treg të prekur.

**Si ta vërtetojmë?**

Ka zona të dyshuara. Do

shkojmë në zonë e Bazit në Burrel, po e marr si shembull. Veterineri atje ka regjistrin themeltar për regjistrimin e bagëtive. Ky nuk i ka të gjitha. Në rast se nuk i ka duhet të merren masa, të ketë edhe ndëshkime.

**Ku u bënë analizat e aflatoksinës, se u fol se do bëheshin jashtë shtetit?**

Janë bërë në Shqipëri, Greqi dhe Itali. Ka pak përmbajtje mbidozë, por produkti nuk është i rrezikshëm për shëndetin e njeriut.

**Pra, jo siç u tha?**

Jo, jo, u bënë për shkak të konkurrencës së pandershme. Misioni im është të mbroj shëndetin e konsumatorit. Kemi pasur qindra e mijëra telefonata se kjo solli panik edhe në popull. Pra, nuk rrezikon shëndetin e konsumatorit në nivelin pak më i lartë i aflatoksinës në qumësht.

**Para disa ditësh shpendërritësit shqiptarë u bënë bashkë dhe hodhën akuza se në Shqipëri po hynë shpendë problematikë kryesisht nga Greqia, të sëmurë me viruse, kryesisht të skartinës që dëm-**

**tojnë shëndetin e popullsisë?**

Në i kemi këto informacione, por shpendët probleme të shëndetit kanë një afat të caktuar. Greqia është vend i BE dhe ka standarde të tjera. Ne dyshojmë tek produkti i therur dhe i përpunuar i këtyre skartinave se ta groposësh duhet të paguash qindra miliona euro në vendin fqinj, ka ustallarë profesionistë abuzues që bëjnë therjen atje dhe janë të lidhur me të ashtuquajturit tregtarë shqiptarë këtu dhe e sjellin si zog të freskët këtu, e paktojnë. Ose e ndajnë në arka me gjoks pule, kofsha etj. Këto produkte kanë ardhur në Shqipëri, por prej 1 viti e gjysmë nuk lejojmë më.

Shpendërritësit thonë se këto shpendë të gjalla vijnë me argumentin se do të theren, nuk theren, por tregtohen ju falsifikohen dokumentet...

Prej 1 viti e gjysmë kjo nuk ndodh më. Këto janë raste sporadike. Ne kemi pas probleme edhe me mishin që vinte nga Peruja, Panamaja, Brazili. Ne shqiptarët i themi atij në gjuhën popullore mish i kalbur. Ka çmim shumë të lirë, me 2 mijë lekë të vjetra një kg, vjen 30 tonë mish dhe përgatit 30 tonë salsicë me këtë.

**Ku është mbajtur ky lloj mish?**

Mbahen si rezerva.

**Nuk kanë rrezik për shëndetin?**

Nuk kanë vlera ushqyese, pra imuniteti i personit që e konsumon bie, mund të lindin probleme të tjera me shëndetin më pas si kanceri e këto gjëra.

**Për sa ngarkesa flasim nga këto të mishit?**

Kanë hyrë 7 ngarkesa në vendin tonë. Dy janë kapur të tjerat janë konsumuar

**Pra, dihet që do hynin?**

Një produkt pa vlera ushqyese ka hyrë bashkë me cilësi të tjera mishi dhe është ngatërruar e pakëtuar si të ishte i tillë. P.sh mishi i Perusë çohet në zona ku ka luftë si Afganistani, me të ushqehen edhe njerëzit në Afrikë.

Këto lloj produktesh nuk shkelin në tregun e BE?

Normal që jo

**Vendimi, kthehet në zonë pedonale, më shumë mundësi për turizëm dhe argëtim**

## Veliaj: "Kalaja e Tiranës do jetë xhevahiri i radhës, ruajmë të vjetrën kur vlen"

Pas Sheshit "Skënderbej" dhe Pazarit të Ri, Tirana do ketë një tjetër hapësirë pedonale, e cila pritet të shndërrohet në një nga vendet më të frekuentuara jo vetëm për kryeqytetasit, por edhe për turistët e huaj. Kalaja e vjetër e Tiranës do t'i kthehet qytetarëve të saj si një hapësirë ku ndërthuret e vjetra me modernen, për të shërbyer si një mjedis kulinarie për gatimet tradicionale shqiptare, por edhe si një zonë për zhvillimin e artizanisë, kulturës dhe artit. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj inspektoi punimet që po kryhen në brendësi të mureve të Kalasë dhe u shpreh i bindur se ky projekt do të jetë xhevahiri i radhës për Tiranën. "Në qetësi, pa zhurmë, pa bujë, pa histeri, e kemi kthyer

"çarshinë" e Kalasë së vjetër të Tiranës, në një kantier, i cili do transformohet në një tjetër hapësirë pedonale, të ngjashme, e ndoshta edhe më të mirë se sa Pazarit të Ri", tha Veliaj. Ai theksoi se kalaja e rinovuar do jetë gati brenda pak javësh, ndërsa tha se ashtu si Pazarit të Ri, edhe kjo hapësirë do krijojë shumë mundësi punësimi dhe të bërit biznes. "Dua t'u bëj thirrje të gjithë sipërmarrjeve, të ngjashme me sipërmarrjet në Pazarin e Ri, që kanë një "tis" të kulturës, të traditës sonë, qoftë në kulinari, qoftë në artizanat, qoftë në muzikë, qoftë në shërbimet e tjera publike, të fillojnë interesimin dhe besoj se shumë shpejt do të jetë një nga pjesët më të vizituara të Tiranës"-tha kryebashkiaku. Veliaj shtoi se ky projekt është një shembull tjetër i suksesit që mund të ketë bashkëpunimi mes privatit dhe publikes.



"Për të gjithë ata njerëz që kanë alergji nga fjala partneritet publik-privat, duhet të vijnë të shohin këtë pjesë të Kalasë së Tiranës, ku pronarët origjinalë, pra familja Top-tani, me qeverinë lokale dhe qendrore, bashkëpunojnë në këtë partneritet publik-privat, që pronën e tyre private ta vënë në shërbim të publikes, si një mjedis për kulinari për

gatimet shqiptare, për artizanet, për art dhe kulturë, si një minipalast pionierësh për kurse dhe muzikë, e për të ruajtur traditën tonë dhe një hapësirë fantastike midis Tiranës moderne të kullave, të shumëkatësheve ultramoderne, me Tiranën tradicionale. Pra, çfarë është për të ruajtur të ruhet dhe t'i kthehet publikut!", përfundoi kryebashkiaku.



Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon dokumentet që duhet të dorëzojnë përfutuesit

Ornela Manjani

Dosjet e viteve 1999-2000, formulari i për të marrë paratë, Lista me 2080 pronarët në të gjithë vendin

Pronarët, që kanë ap likuar për kompen simin e pronës në vitet 1999 dhe 2000, për të cilët ka një vendim për njohjen dhe kompensimin e pronës, duhet të plotësojnë formularin TIP për të marrë paratë. Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon formularin dhe dokumentet që duhet të plotësojnë rreth 2080 përfutues në të gjithë vendin për të marrë kom pensimin në para ose kom pensim fizik. "Gazeta Shqiptare" publikon formu larin, dokumentet si dhe listën me pronarët që duhet të plotësojnë dokumentet për të përfutur kompensimin.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve tip mësohet se kërkuesi, duket të cilësorë faktin se kërkon kom pensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet: Kërkesa për kompen sim financiar/fizik, kon firmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimi të tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër logarive, vërtetim nëse subjekti ka përfutur ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi, do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të kthimit fizikisht të pronës.

Kështu të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall, përfutojnë kompensim finan ciar nga fondi financiar i kom pensimit, deri në masën 50 sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika "a" e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kom pensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kom pensim finan ciar.

PAGESAT E PËRSHPEJTUARA

Pronarët mund të përfutojnë edhe pagesa të përshpejtuara. Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tre vjetësh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së futurës, për pagesën brenda tre viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlerë. Të gjithë subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pa varësisht rendit kronologjik

Formulari aplikimi i kompanisë financiare/fizike. Titulli: FORMULARI APLIKIMI KOMPENSIMI FINANCIAR/FIZIK. Agjencia e Trajtimit të Pronave, Ministria e Drejtësisë. Përfshijë pjesë të 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100.

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQITNI:

- 1. Dokument identifikimi
2. Konfirmim nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes.
3. Vërtetim nga gjykata kompetente nëse vendimi përfundimtar i kompensimit apo vlerësimi i tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore.
4. Dëshmi trashëgimie, nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve
5. Vërtetim për numrin e logarive bankare
6. Vërtetim nëse subjektet (secili prej trashëgimtarëve) kanë përfutur apo jo nga dispozitat për ndarjen e tokës bujqësore (Ky vërtetim merret në DAMT/Këshilli i Qarkut/ Njësia Administrativë, ne atë vendbanim ku trashëgimtar ka banuar deri në vitin 91)
7. Mandate pagese

të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedurë: nga çdo fond vjetor buxhetor i kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjithë subjektet kërkues, të cilët shprehin vullnetin për

t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë, duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit financiar, pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

Table with 4 columns: EMBR(SUBJEKT/KERKUES), VLERESIMI, XHEVAHR SHAHETI, THAVAS THAVASI. Lists names and values for 2080 entries.

10 - SPECIALE

E hënë 16 Korrik 2018

GAZETA SHQIPTARE

Table with 4 columns: Name, ID, Amount, and Name. Lists names and associated numerical values in a grid format.



Table with 4 columns: Name, ID, Amount, and Name. Lists names and their corresponding values in a structured grid format.

Gjendja e acaruar në NATO, pengesa më evidente në mbledhjen në Rusi

# Takimi Trump-Putin në Helsinki, çfarë pritet të ndodhë

## Ambasadori amerikan: Vetë samiti është arritje

Në një konferencë sh typti javën e kaluar ambasadori i Uashingtonit në Moskë u përpoq të shpjegojë pritshmëritë nga takimi javën e ardhshme në Helsinki mes presidentëve Donald Trump dhe Vladimir Putin. I pyetur nëse pret ndonjë marrëveshje konkrete nga ky samit, Jon Huntsman tha, se "Mendoj se fakti që ne kemi një samit në këtë nivel, në këtë kohë në histori, është një arritje në vetvete". Ai pastaj përmendi takimin e fundit midis Trump dhe Kim Jong Un të Koresë së Veriut në Singapor, si një model i mundshëm për bisedimet e ardhshme midis udhëheqësve të SHBA dhe Rusisë. Ndërsa administrata Trump argumenton duke e quajtur takimin Trump-Kim si "ndryshimin në atmosferë" që ka krijuar mundësinë e uljes së tensioneve me Phenianin dhe se ky mund të shihet si sukses, shumë vëzhgues nuk janë dakord me këtë interpretim.

### KRIZA E KRIJUAR VETË

Ata vërejnë, se vetë Trump, me retorikën e tij luftarake, i ka rritur tensionet me Korenë e Veriut dhe vetëm prej tyre realizoi samitin për të shkëputur vëmendjen nga kriza që e shkaktoi ai vetë. Dhe ata, gjithashtu, argumentojnë, se samiti i shumë bujshëm në fakt solli shumë pak nga sa pritej duke dalë prej tij asgjë më shumë veç një deklaratë të paqartë lidhur me qëllimin e administratës së Trump për denuklearizimin e plotë të Koresë së Veriut. Nga ana tjetër, që nga ajo ditë, Pheniani po i pengon angazhimet e qarta që çojnë në këtë drejtim.

### SAMITI I ACARUAR I NATO-S

Pengesa më evidente për takimin Trump-Putin është fakti se presidenti i SHBA-së sapo ka dalë nga një samit thellësisht i acaruar i NATO-s, ku ai vazhdimisht sulmoi kundër aleatëve tradicionalë të Amerikës vetëm pak ditë para se të takohet me liderin e Rusisë, të cilin ai e ka lavdëruar vazhdimisht. Kjo i krijon një mjedis të vështirë atij. Por pavarësisht se mund të duket i habitshëm fakti, që një president amerikan mund të ketë një takim më miqësor me liderin e Rusisë se sa me udhëheqësit e aleatëve evropianë të Amerikës, progresi lidhur me problemet e shumta të mprehta midis Moskës dhe Uashingtonit duket i vështirë, për të mos thënë i pamundur. Problemi kryesor është përzierja e Rusisë në zgjedhjet amerikane, roli i saj në Siri, aneksimi i paligjshëm i Krimesë dhe ndërhyrjet e saj në Ukrainë.

### IMPULSET E TRUMPIT

Por sigurisht, që impulsi i



### AMBASADORI AMERIKAN

Mendoj se fakti që ne kemi një samit në këtë nivel, në këtë kohë në histori, është një arritje në vetvete. Takimi i fundit midis Trump dhe Kim Jong Un të Koresë së Veriut në Singapor është një model i mundshëm për bisedimet e ardhshme midis udhëheqësve të SHBA dhe Rusisë", - tha ambasadori amerikan në Rusi.

Trump ndaj të gjitha këtyre çështjeve është arritja e një lloj ujdje me Kremlinin për të stabilizuar lidhje më të mira me vendin dhe personalisht me Putinin. Ky ka qenë njëri prej disa opsioneve qendrore dhe të qëndrueshme të kuadrit të tij

politik që nga fillimi i fushatës së tij presidenciale. Dhe kurrë nuk mund të përjashtohet, që Trump - veçanërisht gjatë seancës së Helsinkit, ku ai dhe Putin takohen privatisht vetëm me praninë e përkythësve - mund të bëjë lëshime të mëdha të tilla, siç

është p.sh. pranimi i aneksimit të Krimesë nga Kremlini. Kjo është pikërisht ajo që cilësohet si trembim më shumë vëzhguesit e Trumpit dhe të Kremlinit në SHBA dhe në Europë. Por qëkurse Rusia është ndoshta zona e vetme në të cilën Kongresi i krye-

suar prej republikanëve e ka marrë seriozisht rolin e vet për të vepruar si një kontroll i administratës, mundësia e Trumpit për të ndryshuar shpejt dhe në mënyrë të njëanshme qëndrimet kryesore të politikës së jashtme të SHBA duket të jetë e kufizuar.

### VËSHTRITË PËR RUSINË

Kjo dëshmohej nga fakti se pavarësisht nga adresimet e përsëritura të presidentit Trump ndaj Putinit, SHBA-ja e ka forcuar angazhimin e saj ushtarak në krahun lindor të NATO-s dhe i ka shtuar sanksionet kundrejt Rusisë. Gjithashtu, ka mbyllur konsullatën e Rusisë në Seattle dhe ka dëbuar 60 diplomatët rusë - më shumë se të gjitha vendet e tjera evropiane së bashku - kjo në sfondin e helmimit të një ish-agjenti rus dhe vazhës së tij në Britaninë e Madhe në fillim të këtij viti. Duke pasur parasysh se ligjëvënësit amerikanë jo vetëm që do t'i kushtojnë vëmendje bisedimeve të Putinit me Trump, por duket se janë të përgatitur që të pengojnë legjislacionin për çdo lëshim konkret që ai mund të jetë i gatshëm të bëjë për çështje të rëndësishme si Krimeja ose Siria, hapësira e veprimit të presidentit në Helsinki duket disi e kufizuar. Ndërkohë që kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht, se Trumpi, i cili shpesh duket të jetë më shumë i interesuar për fasadën e takimeve se sa rezultatet e tyre, në të vërtetë nuk do ta ketë relativisht më të lehtë arritjen e një marrëveshjeje në Helsinki.

### Mediat: Dy diplomatët donin të korruptonin 3 deputetë

## "Financial Times": Agjentët rusë të dëbuar synonin rrëzimin e 'Tsiprasit' për pengimin e anëtarësimit

Rusët e dëbuar nga Greqia në fillim të kësaj jave synonin rrëzimin e qeverisë "Tsipras", për të shkatërruar marrëveshjen për emrin e ri të Maqedonisë dhe për të penguar anëtarësimin e vendit në NATO. Zbulimi vjen nga prestigjiozja londineze "Financial Times" dhe mediat greke, sipas të cilave shërbimet sekrete ruse e kishin shndërruar Aleksandropolin - një qytet në verilindje të Greqisë - në vatrën e aktivitetit për zgjerimin e influencës së Moskës në Europën Juglindore. Dy diplomatët e dëbuar dhe dy shtetas të tjerë rusë, të cilëve iu ndalua hyrja në Greqi ishin përpjekur të korruptonin 3 deputetë të "Grekëve të Pavarur", aleati i dytë më i madh i koalicionit qeverisës. Ata synonin të ushtronin influencë edhe mes klerit ortodoks dhe grupeve radikale të djathta. "Finan-

### "FINANCIAL TIMES":

"Dy diplomatët e dëbuar dhe dy shtetas të tjerë rusë, të cilëve iu ndalua hyrja në Greqi ishin përpjekur të korruptonin 3 deputetë të "Grekëve të Pavarur", aleati i dytë më i madh i koalicionit qeverisës. Një nga përpjekjet korruptive dështoi pasi u zbulua nga një oficer ushtarak në Aleksandropoli, i cili informoi eprorët e tij, "-shkruan prestigjiozja londineze.

cial Times" shkruan se një nga përpjekjet korruptive dështoi pasi u zbulua nga një oficer ushtarak në Aleksandropoli, i cili informoi eprorët e tij. Në këtë qytet ndodhet një qendër kulturore e financuar nga Moskë, për shkak të pranisë së minoritetit rus. Banorët vendas thonë se me 20 - 30 mijë euro biznesmenët lokalë mund të korruptohen, për shkak të varfërisë që mbizotëron aty. Pavarësisht se ministria e Jashtme ruse i mohoi akuzat,

zyrtarët e qeverisë greke shprehën të indinjuar dhe thonë se ndërhyrje të tilla nuk ka pasur as gjatë luftës së ftohtë, kur Greqia ruante marrëdhëniet e mira me Rusinë. Zyrtarët e departamentit amerikan të shtetit thanë se ky rast është një tjetër fakt se Moskë vijon të jetë e interesuar për zgjerimin e influencës destruktive në rajon, pas tentativave të ngjashme në Mal të Zi dhe Maqedoni.

### SHKURT

#### Arabi, arrestohet gruaja pasi përqafoi këngëtarin

Një grua në Arabinë Saudite është arrestuar pasi vraoi në skenë për të përqaftuar një këngëtar gjatë koncertit. Majid al-Mohandis po performonte në një festival në qytetin perëndimor të Taifit, kur gruaja shkoi në skenë. Videot e postuara në internet treguan momentin kur gruaja u përqaftoi këngëtarin ndërsa stafi i sigurisë u përpoq ta ndalonte. Femrat në Arabinë Saudite nuk lejohen të prekin në publik meshkujt me të cilët ata nuk kanë asnjë lidhje. Mohandis nuk ka komentuar mbi incidentin. Këngëtarin i lindur në Irak, i cili ka, gjithashtu, shtetësi saudite, vazhdoi të performonte pas incidentit.

#### Ajsbergu "kërcënon" shtëpitë e një fshati

Një ajsberg i madh ka lëvizur pranë një fshati në perëndim të Groenlandës, duke nxitur një evakuim të pjesshëm për të parandaluar përmbajtjet. Ajsbergu po duket më si shtëpitë në një kep në fshatin Innaarsuit por është i qëndrueshëm dhe nuk lëviz gjatë natës, raportojnë mediat lokale. Zyrtarët lokalë thonë se kurrë më parë nuk kanë parë një ajsberg të tillë të kësaj madhësie. Verën e kaluar, katër persona vdiqën pasi valët përmbajtjet shtëpitë në pjesën veriperëndimore të Groenlandës pas një tërmeti. 169 banorët të Innaarsuit që jetojnë më pranë ajsbergut janë zhvendosur, tha agjencia daneze e lajmeve Ritzau. Diza ekspertë kanë paralajmëruar se ngjarjet ekstreme të akullnajave rrezikojnë të bëhen më të shpeshta për shkak të ndryshimeve klimatike. Kjo nga ana tjetër rrit rrezikun për cunami. Në qershor, shkencëtarët e Universitetit të Nju Jorkut publikuan videoe e një ajsbergu masiv që shkëputet nga një akullnajë në Groenlandën lindore.

#### Kufiri SHBA-Meksikë, bashkohet me nënën vajza meksikane që qante

Një vajzë 6-vjeçare e El Salvador, që u nda nga familja në kufirin mes SHBA dhe Meksikës dhe ku e qara e saj e regjistruar dhe e shpërndarë nga mediat amerikane kishte prekur opinionin publik, është bashkuar me nënën e saj, Alison Jimena Valencia Madrid dhe nëna e saj Cindy Madrid, u ndanë nga autoritetet amerikane në 13 qershor, pasi hynë ilegalisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga Texasi. Në një regjistrim dëgjohet Alison që i lutet policëve të kufirit të lajmërojnë tezen e saj, të cilën ia mbante mend numrin e telefonit. Bashkimi ka ndodhur të shtunën në Houston.





## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:  
Si të hiqni  
shëndetshëm 5 kg  
brenda 1muaji

## KIRURGJI



Realizohet  
ndërhyrja e parë  
3D në zemër

# Vlera Lekaj:



◆ Mjekja:  
Kur duhet të  
paraqiteni  
direkt te  
specialistët

## Dhimbjet e gjoksit, shenjat që nuk duhet të neglizhoni

Rastet që trajtohen  
me dietë ushqimore

**KESHILLA/ Si të shmangim të nxehnin, nga veshjet te ushqimi**



**D**himbjet e gjoksit mund të paralojmë një sërë sëmundjesh, të cilat në rast se nuk kurohen në kohë mund të kenë pasoja të rënda shëndetësore. Mjekja Vlora Lekaj, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", shpjegon rastet që kërkojnë ndërhyrje të shpejtë dhe rastet që mund të trajtohen me dieta ushqimore.

**Cfarë paralajmërojnë dhimbjet e gjoksit?**

Dhimbjet e gjoksit janë një problem i shpeshtë, i ndeshur në praktikën e përditshme klinike. Përfaqësojnë një simptomatologji komplekse në llojin e tyre, sepse në varësi të karakteristikave që kanë, dhe shenjave shoqëruese, ndajnë origjinën e tyre. Sigurisht rastet më të rrezikshme janë të lidhur me problemet kardiake.

**Si dallohet origjina e dhimbjes?**

Për të dalluar origjinën e tyre, mjekët performojnë te pacienti një sërë testesh dhe ekzaminimesh mjekësore. Por disa njohuri duhet t'i ketë çdo individ, që të arrijë të dallojë llojin e dhimbjes së gjoksit që mund të ndjejë në një moment të caktuar, për të kuptuar origjinën e saj.

**Cilat janë rastet e rënda, kur pacienti duhet të shqetësohet për pasoja në shëndet?**

Rastet e rënda sikur thashë më lart lidhen me zemrën, dhe kërkojnë një ndërhyrje të shpejtë, me medikamente. Një nga dhimbjet e gjoksit të lidhura me zemrën njihet si Angina Pectoris. Angina pectoris ndodh si rezultat i ishëmisë së miokardit, që shkaktohet si pasojë e mospërputhjes së nevojës së miokardit me oksigjen me furnizimin e tij nëpërmjet enëve koronare. Klinikisht pacienti ankon për një fillim gradual të saj, duke arritur intensitetin brenda disa minutash. Qetësohet për pak minuta, pasi pacienti ndalon ecjen apo një aktivitet fizik të caktuar, si dhe pasi vendos nitroglic-

erinë nën gjuhë. Përkruhet më tepër nga pacientët si ndjenjë diskomforti apo sikleti në gjoks dhe jo si një dhimbje e mirëfilltë. Ndodh më së shumti gjatë një aktiviteti fizik, por provokues mund të jetë dhe ambienti i ftohtë, emocionet e forta, apo thithja e tymit të duhanit. Shoqërues të dhimbjes mund të jenë dhe ndjesi të vjellash, lodhje, këputje me djersë të ftohta apo dhe vështirësi e theksuar në frymëmarrje. Në varësi të rëndësisë që ka si shqetësim, klasifikohet ku në rendet e para nuk kemi kufizim të aktivitetit fizik për shkak të shqetësimeve, apo kemi një aktivitet fizik të kufizuar lehtë dhe në rendet më të larta për shkak të rëndësisë së gjendjes, pacienti e ka të kufizuar aktivitetin fizik dhe shqetësimi mund të shfaqet dhe në qetësi. Si dhimbje lokalizohet në dërrasën e kraharorit, por mund të përhapet dhe në kraahun e majtë.

**Cilat janë ekzaminimet më të shpeshta?**

Ekzaminimet më të shpeshta që kryhen në këto raste, janë elektrokardiograma. Një check up i përgjithshëm për të parë gjendjen shëndetësore.


**Cilat janë masat që duhen të merren në lidhje me ushqyerjen?**

Masat që duhen të merren janë

**Mjekja, Vlora Lekaj: Rastet që kërkojnë një ndërhyrje të shpejtë**

# Dhimbjet e gjoksit, shenjat që nuk duhet të neglizhoni

## Rastet që trajtohen me dietë ushqimore



Mjekja e familjes, Vlora Lekaj

kujdesi në dietën ushqimore, sepse janë zbuluar faktorët e yndyrave të larta si një nga shkaktoarët më të shpeshtë. Sigurisht duhet stabilizuar niveli i tensionit arteri-

al, por vendin e parë e mbajnë vlerat e larta të yndyrave në gjak, për shkak se bllokojnë arteriet që furnizojnë zemrën me gjak. Komplikacioni më i rëndë është avanci-

mi i saj drejt infarktit të miokardit që mund të jetë vdekjeprurës. Mjekimi i angina pectoris fillon nga aspirina, si dhe në vazhdim me medikamente antiagregues të gjakut. Sigurisht që kujdesi i pacientit vazhdon më tej me dietën ushqimore, monitorimin e vlerave të glicemisë në gjak, si dhe kontrollin e vazhdueshëm tek mjeku i familjes. Por dhimbjet e gjoksit mund të kenë dhe origjinë tjetër, kështu ato mund të jenë me origjinë nga stomaku, ezofagu sidomos kur shoqërohem me probleme të ndryshme me tretjen e ushqimit. Pacientët ankojnë për aciditet të shtuar, dhe zakonisht qetësohen nga barnat antiacide. Tjetër origjinë e dhimbjeve të gjoksit mund të jenë nga mushkëritë sidomos kur shoqërohen me kollë apo dhe ethe me temperaturë të lartë, si dhe dhimbjet nga problemet e qafës si spondiloartroza, e cila shoqërohet dhe me kufizim të lëvizjeve të qafës si dhe me mpirje krahu. Tek mjeku i familjes këto shqetësime të pacientëve janë të shpeshta. Nëse jeni mbi 40 vjeç, dhe këto dhimbje iu shfaqen papritur duhet patjetër të kërkoni asistencë mjekësore për çdo rast. Ndër sëmundjet kronike angina pectoris është e shpeshtë, dhe 1 ndër 3 pacientë merr mjekim rregullisht.

**Alarmi i mjekut: Adoleshentët shqiptarë po i pinë si 'karamelë' pilulët e emergjencës**

Vajzat e reja po i përdorin ato si "karamelë", thonë ata. Ndërkohë, një pilulë urgjence nuk rekomandohet të merret ose maksimumi të përdoret vetëm një herë, pasi dëmet shëndetësore dhe psikologjike janë afatgjata. Mjeku gjinekolog Redi Hoxhallari rekomandon që femrat t'i drejtohen metodave të kontracepsionit të planifikuar. "Ka dy lloje kontracepsioni urgjence dhe planifikim familjar. Pilula mund të përdoret vetëm një herë në rastet e urgjencës", thotë mjeku Redi Hoxhallari. Me një përvojë 15-vjeçare, mjeku Hoxhallari tregon raste konkrete nga puna e tij. "Pilula e urgjencës nuk duhet marrë me rekomandim të farmacistit. Ka raste që vajzat e marrin 4,5 apo 6 herë në vit. Por ka edhe raste kur vajzat e reja e marrin çdo muaj", thotë ai. Kontracepsioni i urgjencës ka një trend në rritje thotë mjeku. Moshat që përdorin pilulët e urgjencës variojnë. "60 përqind nuk janë ende adultë, pra janë më pak se 17 vjeç", tregon mjeku. Kjo ndikon jo vetëm në shëndetin riprodhues të femrës. "Sjell probleme psikologjike dhe dëmtime që zgjasin gjithë jetën", thotë mjeku.

**Shefi i kardiokirurgjisë shpjegon përfitimet e pacientëve Realizohet ndërhyrja e parë 3D në zemër**

Një kufi i progresit shkencor i sapo arritur nga ekipi i kardiokirurgjisë pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë. Rasti i cili i nënshtrohet kirurgjisë minivasive të valvolës mitrale nën videoskopi. Lajmi është bërë i ditur nga shefi i kardiokirurgjisë, profesor Edvin Prifti, i cili bënte i ditur se ky është rasti i parë në vendin tonë si dhe në ditë të ditës në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe me gjerë. "Procedura kirurgjikale konsiston në implantimin brenda kraharorit në anën e djathtë të pacientit të një sistemi kamerash 3-D të cilat bëjnë të mundur një vizualizim direkt nën një hapje





Voltiza Duro

Trajtimi me bimë mjekësore për të humbur kilet e tepërta

# Ylli Merja:

## Si të hiqni shëndetshëm 5 kg brenda 1 muaji

Si ndikojnë kaffja, kanella, mjalti dhe xhinxheri në peshën tuaj

Me rritjen e temperaturave, të gjithë fillojnë planet për të kaluar kohën e lirë në plazh. Kështu rritet dëshira për të pasur një trup të bukur, elegant dhe të tonifikuar. Është shumë e lehtë për të humbur peshë në verë, prandaj nëse keni dëshirë të sillni trupin në formë, tani është momenti më i mirë. Ka shumë mënyra për të humbur peshë shpejt, por gjëja më e rëndësishme është vendosmëria juaj për të kontrolluar vetveten kur jeni i/e uritur. Gjithashtu, nuk duhet të peshoheni çdo ditë, pasi ndryshimi nuk duket direkt 30 minuta pasi keni bërë ushtrimet fizike, apo një ditë më pas. Mund të peshoheni një herë në javë.

### SI NDOH DOBËSIMI?

Nëse arrini të kuptoni sesi ndodh dobësimiti në organizëm, atëherë mund të kuptoni që ky është një proces që duhet të ndodhë ngadalë për një periudhë të caktuar, pasi nuk mund të arrihet që brenda një jave të biem në peshë 3 kilogramë. Gjithashtu, dobësimiti duhet të bëhet gradualisht; mosngrënia për kohë të gjatë e dëmton organizmin, megjithëse ju mund të ndjeni vetëm dobësi fizike, dëmtimi që shkaktohet mund të shfaqet pas disa muajsh apo edhe viteve.

Procesi i dobësimit quhet ndryshe procesi i ketozës. Ky proces aktivizohet në organizëm kur trupi ka nevojë për energji dhe nuk është duke marrë këtë energji nga ushqimet, pra është në një periudhë me mungesë ushqimi. Çdo gjë që ne hamë kthehet në glukozë, në sheqer në organizëm dhe pastaj përdoret si energji. Kur sheqeri mungon, vihet në punë ketogjeneza, procesi i tretjes së yndyrave, i cili ndodh në mëlç. Gjatë dobësimit duhet të kujdesemi në pastrimin e mëlçisë, tëmthit dhe veshkave. Tëmthi fillon të krijojë gurë dhe llumë nëse dobësimiti ndodh shumë shpejt, pasi çlirohen shumë qeliza kolesteroli në gjak dhe formojnë gurët. Gjithashtu, në veshka fillon të sekretohet shumë acid urik nga reaksionet kimike që ndodhin në organizëm, prandaj duhet bërë shpëlarje e veshkave çdo ditë. Gjatë dobësimit pH e gjakut kthehet në acid. Të gjitha këto faktorë mund të jenë të dëmshëm nëse nuk dobësohemi mënyrë të kontrolluar e të ngadalë.



Vili Merja

### TRAJTIMI ME BIMË MJEKËSORE

Për t'u dobësuar më shpejt duhet të konsumoni 3 vakte kryesore dhe 2 vakte të ndërmjetme. Mëngjesi duhet të jetë vakti më i madh, sepse në mëngjes trupi mund të prodhojë të gjitha enzimat tretëse shumë shpejt, është më aktiv dhe gati për të filluar ditën. Në mëngjes mund të konsumoni këtë përzierje: në një pjatë shtohet 1 gotë kos; 1 lugë kafe vaj lini; 1 lugë gjelle me fara chia; 1 lugë kafe me kanellë; 1 lugë kafe me xhinxher si dhe 1 lugë kafe me mjaltë. Lihet të zbutet 5-10 minuta dhe konsumohet si mëngjes. Vakti i fundit duhet të jetë në orën 7 pasdite. Pas kësaj kohe mund të pini çaj ose të konsumoni ndonjë fruit nëse keni shumë uri, por nuk duhet të hani ushqime të tjera. Këshillohet të ndërprisni tërësisht ëmbëlsirat, alkoolin,

sheqerin minimizojeni në ¼ lugë kafe në ditë (përfshirë këtu edhe sheqer në kafe/çaj); brumërat si makarona, buka e bardhë, biskotat e gatshme, ushqimet e skuqura, ushqimet e paketuara që përmbajnë konservantë, fryrës e kimikate të tjera. Hapi tjetër për



klorogjenik që ndihmon në shkrirjen e yndyrave nën lëkurë. Ushqimet që mund të përdorni janë mish, veza, kosi, suprat e ndryshme, etj.

Raporti i proteinave me karbohidratet duhet të jetë 3 pjesë proteina dhe 1 pjesë karbohidrate. Disa nga ushqimet e shëndetshme që ndikojnë në rënie në peshë janë këto: vajra të shëndetshme merren nga: vaj lini, bajamet, fara chia, vaj ulliri; vitamina: luleshtrydhe, kivi, bostani, boronica e zezë, luleshtrydhe të egra. Frutat dhe perimet me fibra ndihmojnë në përthithjen më të mirë të vlerave ushqyese dhe ndi-



t'u dobësuar është lëvizja. Është e rëndësishme të bëni një jetë aktive. Edhe pse ambienti i punës mund t'ju privojë, duhet të paktën 3 herë në javë të bëni 1 orë ecje. Mungesa e lëvizjes dobëson muskujt e trupit të cilët bëhen të butë. Konsumimi i ujit duhet të jetë 1.5-2 litra ujë në ditë. Këtu përfshihen edhe çaji apo lëngjet e frutave. Nuk duhet të konsumoni lëngje me gaz gjatë kësaj periudhe, pasi ato përmbajnë shumë sheqer. Mund të përdorni kafe, pasi përmban acidin

hmojnë jashtëqitjen. Proteinat mund të merren nga mish i pulës dhe peshkut, por edhe veza përmban shumë aminoacide dhe këshillohet të përdoret çdo ditë. Konsumoni një vakt vetëm me hithra, lakra të ndryshme të ziera, shtojini pak vaj ulliri dhe 1 lugë uthull mollë e egër. Lakrat e egra përmbajnë vitaminë, antioksidantë dhe ndihmojnë rënie në peshë. Hithrat, meshtekna, mustaqet e misrit, drunakuqi janë bimë të cilat largojnë ujë e tepërt në organizëm dhe ndihmojnë tretjen e yndyrave nën lëkurë. Ky mikser çajrash për dobësim përdoret kështu: 1 paketë hidhet në 2 litra ujë që valon, lihet të ziejë 2 minuta, e të ftohet rreth 20 minuta. Kullojeni dhe ruajeni në frigorifer çajin. Konsumohet 3 herë nga 1 gotë në ditë pas ushqimit.



Këshilla si duhet të shmangim të nxehtin nga veshjet te ushqimi

# Vapa, rreziku që na kanoset

Më të rrezikuar nga i nxehti janë pacientët që vuajnë nga hipertensioni, nga problemet e zendrës dhe insuficiencia renale, ose që përdorin ilaçe që përkeqësojnë efektet e goditjes së të nxehtit

Me ardhjen e verës, Instituti i Shëndetit Publik ka nisur një fushatë ndërgjegjësimi për rreziqet e motit të nxehtë, sidomos për sa iu përket kategorive të njerëzve në nevojë, si të moshuarit dhe fëmijët. Ky institucion kërkon që të mbështeten rregullat e fushatës me këshilla parandal-



uese për të gjithë popullatën, sidomos për fëmijët, adoleshentët dhe të moshuarit. Mjekët e familjes duhet të kenë parasysh se simptomat e të nxehtit të tepërt janë ngërçet, edema, skuqja e lëkurës, goditja nga i nxehti dhe dehidratimi. I nxehti mund ta komplikojë situatën e pacientëve që vuajnë nga hipertensioni, nga problemet e zendrës dhe insuficiencia renale, ose që përdorin ilaçe që përkeqësojnë efektet e goditjes së të nxehtit.

**SHENJAT**  
Shenjat paralajmëruese

që duhet të mbahen parasysh janë: zbehja, marramendja, të vjellat, puls i dobët, temperatura e ngritur. Si masë paraprake është mirë të errësohen dhomat dhe hapësirat e përbashkëta, të mbahet një temperaturë me ajër të kondicionuar jo më poshtë se 25° C, të kontrollohet hidratimi, tensioni dhe temperatura e të shtruarve të moshuar.

**RREZIQET NGA TEMPERATURAT E LARTA**

Temperaturat e larta në verë kanë ndikim negativ në organizmin e fëmijës. Fëmijët janë të ndjeshëm ndaj efekteve të këtyre



temperaturave, sepse metabolizmi i tyre ndryshon nga metabolizmi i të rriturve, qendra e rregullimit të temperaturës është e papjekur; aftësia për djersitje është më e pakët, masa e trupit është e vogël, po ashtu edhe vëllimi i gjakut. Gjithashtu, ata mbështeten te të tjerët për të rregulluar temperaturën e mjedisit të tyre apo dhe për të siguruar marrjen e lëngjeve të nevojshme.

**TE TË RINJTË**  
Disa rregulla të cilët me siguri

do të ndihmojnë për të mbrojtur shëndetin e të rinjve; mos u largoni nga shtëpia gjatë orëve të nxehta dhe mbronni dritaret nga dielli, pini një deri në dy litra ujë në ditë, lëngje frutash etj., konsumoni ushqime të lehta të ndara në porcione, konsumoni fruta të bollshme dhe perime të freskëta, freskoni dhomat me ventilatorë apo kondicionerë, me temperaturë jo poshtë 25° C. Ajrosni makinën që është për një kohë të gjatë në diell, duke hapur dyert dhe vënë kondicioner

para se të lëvizni me të. Përdorni pajisjet e ruajtjes nga dielli dhe mos i lini fëmijët vetëm në makinë. Bëni banja dhe duše, por jo nën temperaturat 25° C. Ruani ilaçet nga burimet e nxehtësisë dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruani në frigorifer të gjitha ilaçet që kërkojnë temperatura jo më të larta se 25-30° C, dhe të gjitha shishet e shurupeve apo ilaçet me pika, të cilat sapo janë hapur: Fëmijëve, ashtu si të rriturve, dielli u sjell përfitime të rëndësishme për







# Kategoritë më të prekura dhe simptomat që nuk duhen neglizhuar



humorin, sistemin imunitar, kockat dhe lëkurën. Ekspozimi i pakujdesshëm dhe i papërgjegjshëm mund të ketë pasojë negative të tilla si djegie nga dielli, dhe në një afat kohor më të gjatë fillimin e tumorëve, përfshirë melanomat.

## PËR TË MOSHUARIT KËSHILLOHET:

-Mjediset e brendshme të banesës të mbahen në një temperaturë konstante rreth 26° C;

-Të moshuarit të mos dalin nga shtëpia nga ora 11-18;

-Gjatë gjithë kohës të konsumojnë lëngje jo shumë të ftohta;

-Të vishen me veshje me ngjyra të hapura prej lini ose pambuku.

Përveç të moshuarve, grupe të rrezikuara janë fëmijët, foshnjat, të sëmurët kronikë, personat të cilët

duhet të jenë të shoqëruar me kujdestarë, dhe ata që kryejnë aktivitete fizike jashtë.

## NDIHMA E PARË

Në rast se dikush ndihet keq nga i nxehti dhe është në pritje të ndihmës së kualifikuar është mirë që personi të vendoset në një vend të freskët, t'i ftohet trupi duke e mbështjellë me një çarçaf të lagur ose duke e spërkatur me ujë, t'i jepet të pijë lëngje si dhe të mos i jepet asnjë ilaç për uljen e temperaturës.

## ÇFARË SHKAKTON VAPA TË FEMIJEVE

-Irritim të lëkurës nga nxehtësia, puçrrat e vapës. Puçrra të vogla të kuqe shfaqen në pjesët ku trupi është më i nxehtë, sidomos në qafë, fytyrë, bërryla dhe poshtë gjunjëve.

-Çrregullime diarreike, diar-



reja karakterizohet nga të dala të ujshme e të shpeshta të fëmijës (6-7 herë në ditë të foshnjat). Diarreja është më e shpeshtë të fëmijët nga 6 muajsh deri në 2 vjeç.

-Të vjella, diarreja mund të shfaqet edhe me të vjella, e cila është shenjë e infeksioneve të shkaktuara nga viruset apo bakteret. Infeksionet nga viruset apo bakteret shfaqen më shumë në muajt e verës dhe shkaktohen nga

temperaturat e larta apo nga ushqimet e infektuara.

-Herpes simplex është infeksion i lëkurës i shkaktuar nga virusi me të njëjtin emër, shfaqet në formën e plagës dhe kalon nga prindërit të fëmija me anë të puthjes. Lëkura skuqet dhe shfaqen puçrra të vogla rreth buzës dhe poshtë hundës, të cilat bashkohen dhe formojnë plagë. Fëmija duhet çuar te mjeku dhe nuk duhet lejuar të prekë fytyrën.

-Goditje nga dielli si pasojë e ekspozimit të fëmijës në rrezet shumë të forta të diellit. Fëmija djersin, humbet lëngjet dhe dehidrohet.

## MBROJTJA E FEMIJEVE NGA DIELLI

Foshnjat nga 0-6 muaj/ Fosh-

për të mbrojtur fëmijët nga rrezet që vijnë përmes dritares.

-Shëtitini me karrocë herët në mëngjes përpara orës 10 dhe pas orës 17, duke përdorur mbrojtësen e diellit që kanë karrocet.

-Vishini me rroba të lehta pambuku, të cilat mbulojnë krahët dhe këmbët.

-Zgjidhni një kapelë të gjerë që t'i mbrojtë fëmijës fytyrën, qafën dhe veshët.

Foshnjat nga 6-12 muaj/ Foshnjave apo bebeve në këtë moshë duhet t'u përdoret krem mbrojtës ndaj diellit.

-Mbrojtja është e njëjtë si të foshnjat e vogla, vetëm tani duhet të përdoret edhe kremi i diellit.

-Përdoren kremra me faktor mbrojtës mbi 20, dhe lyhen pjesët e zbuluara të fëmijës.

-Shumë e rëndësishme është që kremi t'i vihet foshnjës rreth 30 minuta para se të dalë jashtë, t'i rivihet prapë çdo dy orë, pas larjeve në det apo nëse është djersitur shumë.

-Fëmijët e vegjël 1 vjeç deri në 6 vjeç/ Sigurohuni që fëmija të rrijë në hije nga ora 10-17. Kontrolloni mjedisin e jashtëm ku fëmija juaj luan për t'u siguruar që ka hije të mjaftueshme.

-Sigurohuni që fëmija të jetë i veshur me rroba të lehta pambuku, të lyhet me krem mbrojtës me faktor mbrojtës mbi 20 që të jetë rezistentë ndaj ujit.

-Fëmijët duhet të mbajnë kapelë dhe syze dielli. Kapela duhet të jetë e gjerë që t'i mbrojtë qafën, fytyrën dhe veshët.

## KUJDES!

-Mos dilni në orët e nxehta;

-Vishni rroba të lehta; -Pini 2 litra ujë në ditë dhe hani sa më shumë fruta.

-Përdorni mburojat e lëvizshme në dritaren e makinës

## PROTESTA

## "EDHE TI, BRUT?"

Teatri, Vlahutin do presë artistët,  
Çipi: E vërteta e takimit me Veliajn

Neritan Liçaj: Duan të shkrijnë trupën e aktorëve të teatrit

Fatmira Nikolli

Artistët protestojnë prej muajsh për mbrojtjen e dy (jo një, por dy) teatrove kombëtarë dhe po prej muajsh tkurren. Nuk ka më vlerë të pyesim "Edhe ti, Brut?", sepse nuk do e dimë se kush është Bruti i radhës dhe as nëse janë në lartësinë e Brutit. Por tek artistët tkurren, qytetarët shtohen dhe me ta zërat intelektualë kundër shndërrimit të zonës, bëhen gjithnjë e më shumë.

Lufta për mbrojtjen e teatrit, ka përdorur çdo mjet për t'ia arritur qëllimit. Makina propagandistike e palës që kërkon shembjen e teatrit, ia doli njëfarësoj të provojë se "kazani" zien fort në temperatura të larta dhe se qëllimi, justifikon mjetin. Ne qeshim kur vite më parë, blisheshin deputetët për numra votash në parlament. Tani, nuk ka më asgjë për të qeshur, madje as për të vënë buzën në gaz. Grupi i protestuesve, me ditë pak e me ditë shumë, duke mos qenë i strukturuar jo vetëm që ka humbur me kohën, por nuk ia ka dalë të nxjerrë në shesh një imazh që bashkon masat. Kjo, jo për fajin e tyre. Të gjendur të papërgatitur e me humbje në radhët e veta, ata mjaft që arrijnë të mbajnë në këmbë protestën. Puna e tyre vullnetare, nisur nga besimi i justifikuar për të mbrojtur teatrot e truallin publik, ka përballë një makineri gjigande propagande, me të punësuar që paguhen qoftë edhe për të nxjerrë foton e Ndricim Xhepës si administrator pallati, a thua se kjo qenqërkësh ndonjë farë merite e kësaj qeverie, e njëjta që i detyroi artistët e TKOB të firmosnin kontratat duke i kërcënuar me pagën për të cilën kishin punuar. Por ndërsa Tirana hesht në sipërfaqe dhe gumëzhin poshtë saj, shogëria e zhytur në apati, e ngërthyer nga dëshira për të ikur, e gjetur e pashpresë, nuk denjon më as të protestojë. duke bërë pre kreytje e lehtë për propagandën dhe duke ia servirur asaj me një lehtësi të paimagjinueshme suksesin. Rrjedhimisht,



jemi shndërruar në audienca pritëse ose siç thotë Hannah Arendt, jemi shndërruar thjesht në sende përdorimi. E nëse kemi parasysh se nëse të gjithë janë fajtorë që po heshtin, askush nuk është referuar së njëjtës autorë, banaliteti i së keqes me të cilin jemi mësuar është kaq i frikshëm. Mbizotërimi i logjikës "ku ishit ju kur" na lë edhe tani duarkryq vetëm se nuk "ishim kur". Abstenimi në një situatë si kjo, është vetëm një "normalitet i frikshëm". Në terma të tjera duke marrë parasysh marzhin e gabimit në çdo krahasim, ne jemi "Adolf Eichmann" dhe kemi fajin tonë në këtë mes.

## VLAHUTIN

Prej disa ditësh Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit i ka



## PROJEKTI

Znj. Romana Vlahutin "na është përgjigjur që sapo të kthehet nga Brukseli do të na rezervojë një takim me një delegacion përfaqësues të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, ndërkohë jemi në pritje të përgjigjes për takim nga Komisioneri evropian Z. Hahn, përgjatë vizitës që ai do të bëjë ditën e martë në Tiranë".

nisur disa emrave të njohur të Bashkimit Evropian Johannes Hahn, Romana Vlahutin, Federica Mogherini, Eduard Kukan, Tanja Fajon, Knut Fleckenstein dhe drejtuesve të institucioneve, kërkesën për të shqyrtuar shkeljet që janë bërë në ligjin për shembjen e Teatrit në lidhje me Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit. Shkeljet në anën tjetër u janë renditur edhe në letrën që drejtuar atyre. Ndërkaq, Aleanca për mbrojtjen e Teatrit ka bërë me dije së fundmi se Znj. Romana Vlahutin "na është përgjigjur që sapo të kthehet nga Brukseli do të na rezervojë një takim me një delegacion përfaqësues të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, ndërkohë jemi në pritje të përgjigjes për takim nga Komisioneri evropian Z. Hahn, përgjatë vizitës që ai do të bëjë ditën e martë në Tiranë".

## DISKUTIMET

Kam se nuk jam dakord me propozimin, sepse kërkesa thjesht për konkurs, pa specifikuar objektin e konkursit, linte të hapur shtegun për shembjen e dy teatrove kombëtare me alibin e konkursit ndërkombëtar. Megjithatë, duke qenë partizan i demokracisë në çdo situatë, e hodha për diskutim propozimin e tij

## ME TRUP PËR TRUPËN

Prej muajsh aktorë të ndryshëm qenë zotuar se do e ruanin me trup godinën e teatrit. Së fundmi, aktori

Neritan Liçaj, thotë se Rama nuk do ndalet vetëm te vjedhja e tokës së Teatrit Kombëtar ditën të diellit! Do të shkatërrroj dhe institucionin duke shkriur trupën e aktorëve dhe duke na flakur të gjithëve në rrugë dhe t'i kthehet idesë së tij kur ishte ministër Kulturë - të njëjti Teatri Kombëtar servis si të jetë gomisteri. Nuk do ketë më një trupë aktorësh, por vetëm administratë dhe kush të dojë të vërë shfaqje. Do ishte ky një Teatër Kombëtar?!", pyet Neritan Liçaj, duke shtuar se "Jo, do ishte një tallje me këtë institucion kaq me vlerë. A ka më turp për një mësues vizatimi se kaq?! Kuft i shërben kjo politikë antikombëtare. Aktor hapini sytë po rrezikohet ekzistenca juaj. Ma besoni këtë". Sipas Liçaj, kjo betejë që po bëj bashkë me të tjerët ka hyrë dhe do mbetet në jetën time si pjesëmarrja më me vlerë e gjithçkaje kam bërë. "Teatri Kombëtar do jetë atëherë siç ka qenë dhe trupa e tij do jetë krenaria e Shqipërisë. Pra, ta mbrojmë godinën dhe institucionin, trupën dhe dinjitetin e aktorëve, trashëgiminë, vlerën historike dhe gjithçka përfaqëson ajo godinë dhe ajo trupë. Kam 20 vjet që bëj këtë betejë kundër

kësaj shushunje njeri dhe do vazhdoj ta bëj", përfundon ai.

## PASKUINTAT E NJË TAKIMI

Pas një interviste për një të përditshme, ku regjisori Altin Basha foli për ditën që ai bashkë me Ben Derhemën e Alfred Trebickën takuan kreun e bashkisë Erion Veliajn, ka dhënë versionin e tij edhe regjisori

Kastriot Çipi. "Kolegu Altin Basha ka dhënë një intervistë me titull 'Ramë dakord, por Aleanca na tradhtoi...'. Në intervistë ai shprehet se ka shkuar në takimin e Erion Veliajt si përfaqësues i Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit dhe se është mandatar si i tillë nga një takim me pjesëmarrjen e nëntë artistëve, katër prej të cilëve anëtarë të Sindikatës së Artistëve të Skenës dhe Ekranit (SASE), në të cilin nuk mund të merrja pjesë pasi ndodhesha jashtë vendit. Më tej, ai sqaron se pas këtij takimi, ka takuar Gjergj Bojaxhiun dhe ai i ka thënë se duhet të ngulë këmbë në kërkesën që, në ligjin special për shembjen e teatrove kombëtare, të përfshihet konkursi ndërkombëtar", nis Çipi rrëfimin e takimit.

Ai thotë se sa i takon "telefonit të prishur", mes tij, Gjergj Bojaxhiut dhe Altin Bashës, ajo që Çipi mund të provojë me fotot nga ekranin të mesazheve, është se: "Me deklaratën e formuluar nga Gjergj Bojaxhiu, si propozim për t'u pranuar nga Aleanca, jam njohur më 27 qershor, ora 10.00, pra në kohën kur takimi me Veliajn kishte një orë që kishte filluar. Në ora 10.48 i kam thënë Bojaxhiut se nuk jam dakord me propozimin e tij, sepse kërkesa thjesht për konkurs, pa specifikuar objektin e konkursit, linte të hapur shtegun për shembjen e dy teatrove kombëtare me alibin e konkursit ndërkombëtar. Megjithatë, duke qenë partizan i demokracisë në çdo situatë, e hodha për diskutim propozimin e tij. Në ora 12.40 e kam njohur Bojaxhiun se propozimi i tij nuk ishte pranuar jo vetëm nga anëtarët joartistë, por as nga artistët në kryesinë Aleancës. Në ora 13.00 e kam njohur të kryesinë e Aleancës ka miratuar versionin tim, ku shkruhej e zezë në të bardhë 'konkurs ndërkombëtar për rikonstrukcionin ose restaurimin e TK dhe TKE', ndërkohë që konfirmohej se projekt-ligji thjesht nuk duhej miratuar".



## IN MEMORIAM



Luan Rama\*

## Të duash Parisin dhe të vdesësh në të...

*Në kujtim të Ilia Tërpinit, që u nda nga jeta në kryeqytetin francez*

Miku im i dashur Ilia Tërpini kish te një dashuri të jashtëzakonshme për Parisin, jo vetëm për arsye familjare dhe vizitat e shpeshta që ai ka bërë në këtë qytet, me rrugët, sheshet historike, urat e shumta mbi Senë, banesat "haussmaniane" rreth tij, por dhe nga ajo që syri i tij prej artisti nuk ngopej me këtë qytet të lashtë dhe tani pyes veten se kushe-di sa mijëra fotografi do ketë lënë nga kjo "dashuri". Parisi në imazhe, Parisi i parë nga syri i një mjeshtri, nga syri i një operatori që e kishte sinonim të vetvetes të bukurën, hirësitë, peizazhin, portretet, kompozimet. Sa herë jam takuar me të në Paris, në kafenetë e bukur parisiane, në ambasadë, me miq të shumtë, buzë Senës, gjithnjë shikoja shkëlqimin e syve të tij, një lloj drite që rrallë herë e kisha parë tek ndonjë tjetër artist, siç janë nganjëherë sytë e fëmijëve para mrekullisë. Ilia ishte një këngë gëzimi, pasi të rrije me të në sheshet e xhirimit, të udhëtoje me të nëpër malet shqiptare, të xhiroje një reportazh, të flije në një dhomë me të, ai të jepte padashur një lloj entuziazmi. Kishte një vështrim të çuditshëm për jetën, edhe pse jeta jonë ishte e trishtë. Mbjaj mend kur me të dhe Kujtim Çashkun, në një shi të rrëmbyeshëm dhe menjë "gaz" kinez, mbërritëm një muzg në Bulqizë dhe kur nga dritarja e hotelit pamë çuditërisht yje në një qiell. Por ne sapo ishim ndarë nga ai qiell i errët e plot vetëtimta. Jo, nuk ishin yje, por fenerë në telat me gjemba të kampit të



burgosurve që punonin poshtë në minierë... Dhe ne do nisim xhirimet e atij dokumentari, një xhirim i vështirë, 300 metra nën tokë, por Llui, siç i thërrisnim ne, veshur me çizme filmonte minatorët e trishtë dhe hynte në bisedë me ta. Kishte një lloj dashurie të madhe Llui që e ndante dhe me të tjerët. Në galeritë e Bulqizës, trishtit kthehej në një lloj dëshire për jetën. Me Lluin të gjithë kishin dëshirë ta kishin në filmat

e tyre, dokumentarë apo artistik: humori i tij e kthente lodhjen në një gjendje të gëzuar. Kisha gjithnjë dëshirë të shkoja në kabinën e tij të operatorit, një kabinë e mjerë, e ngushtë, ku njeriu mezi mund të rrotullohej, por aty ishin hirësitë e Lluit, fotografitë e tij artistike që s'mund të tregoheshin jashtë, një sup i zhveshur, një qafë e bukur gati hynjore, vajzëria në mrekullinë e vet, dhe drita e fotografisë që kishte

arritur ta kapte atë që quhet magjike, brenda atij aparati të vogël, në "camera obscura", ku mjeshtri arrinte të ngjizte mrekullinë e tij. Gjithçka linte gjurmë aty, gjurma e dritës, jetës. Ky njeri gjithnjë në lëvizje, në nxitim, sikur donte të ecte para kohës, që të mund ta fiksonte kohën njerëzore në çastin kur para tij do shfaqeshin njerëzit, objektet, dashuritë, ashtu si një Xiga Vertov, gjithnjë me hapin e madh për të për-



shkuar distancat gjeografike dhe ato njerëzore.

Çuditërisht, nga Normandia, mora vesh se miku ynë Ilia e kishte mbyllur aparatin e tij që kurrë nuk e shqiste nga dora. Ai vdiq papritur në Parisin që aq shumë e donte. Të dashurosh një vend si Franca dhe të vdesësh në të, një koincidencë e veçantë, ashtu siç kishte ndodhur me Oscar Wilde, Jim Morisson e shumë të tjerë të mrekulluar nga Parisi, kjo "festë e pambarrimë" siç e quante Heminguej. Të vdesësh, kesh-

tu, dhe dhimbja për familjen dhe miqtë e tij është më e lehtë, pasi në udhën që është nisur, drita e fotografive dhe e filmave që ka realizuar do ta shoqërojë gjithnjë. Më duhet të kthehem nga Normandia t'i jap përshëndetjen e fundit mikut tim të dashur. Ndoshta aparatin e ka ende me vete pranë tij si një ogur për jetën tjetër...

(Foto - nga dita e parë e xhirimit të filmit "Të Pafuarit")  
Luan Rama.

Opinion i Ditës

# Interesim i lartë dhe pak pritshmëri nga takimi Trump-Putin

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

... e mundshme për diskutim, për rezultatet e pritshmëritë konkrete, shoqëruar edhe me vlerësime, kritika e hamendësime të llojeve të ndryshme. Natyrisht, në këtë ndeshmëri të lartë bën pjesë sidomos edhe grindja brenda perëndimit, që u shfaq edhe në samitin e fundit të NATO-s në Bruksel, që u shoqërua me pyetjen se kush është fitimtari e humbësi i këtij takimi të Helsinkit. Edhe pse në prag të takimit u njoftua për akuzën ndaj 12 punonjësve të shërbimit sekret rus, shoqëruar me aludimet e një anulimi të mundshëm të takimit, duket se takimi do të zhvillohet, sepse për realizimin e tij kanë interes si Trump ashtu dhe Putin, edhe pse përmbajtja e interesave nuk mund të jetë e njëjtë. Natyrisht, Putin ka interes të veçantë, sepse mendon se kështu do të legalizohet statusi i Rusisë si superfuqi botërore, që ka qenë ambicie e madhe edhe personale e Putin.

Rusia është një aktor i rëndësishëm gjeopolitik rajonal në Europë, por edhe në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky takim shihet me shumë interes nga Putini si një mundësi e fuqisë në muze e strategjisë së izolimit të Rusisë, por edhe si një shprehje e çlirimit të mundshëm nga sanksionet e perëndimit të bashkuar e tashmë të grindur. Favarësisht interesave konkrete të dy palëve, takimi i Helsinkit vlerësohet si fakt i prevalimit të dialogut para konfrontimit. Nga dialogu fiton siguria, stabiliteti e paqja, fiton ulja e tensioneve dhe kërcënimeve hibride.

Ky takim i Trump me Putin ka si paradhomë zhvillimet në G7, një luftë tregtare jo vetëm me Kinën, por edhe me partnerët euroatlantikë të SHBA, ka samitin e fundit të NATO-s, ku presidenti Trump adresoi përsëri kritikën ndaj aleatëve, sa i përket shpenzimeve për mbrojtjen, që disa i shtyjnë të flasin për një çarje përfundimtare apo për fundin e perëndimit, që nuk mund të mos favorizojë Rusinë e Putinin në bisedimet kokë më kokë me presidentin Trump. Natyrisht, duhet kuptuar qartë se, në takimin me aleatët euroatlantikë, presidenti Trump ishte në një njëzëris ku shumë gjëra esenciale i bashkon, ndërsa në takimin me Putin ka shumë gjëra që i ndan dhe ato janë vlerë të rëndësishme. Putini i intereson maksimalisht grindja perëndimit, se ushqen interesa konkrete e të rëndësishme ekonomike e tregtare, por edhe strategjike. Kuptohet që presidenti Trump do t'i kërkojë Putinit përgjegjshmëri të lartë ndaj zhvillimeve botërore, por dhe respektimin e vendit, rolit dhe kontributit të perëndimit dhe SHBA në mbrojtjen e stabilitetit, paqes e sigurisë në zhvillimet botërore, respektimin e ligjit e të drejtës ndërkombëtare. Putini do të deklarojë pozitivisht, sepse interes madhor në këtë takim ka që të bëjë një hap konkret të dakordësuar me presidentin Trump për ndarjen e rolit dhe të fuqisë me SHBA. Putini, si të thuash, në këtë mënyrë legalizon statusin e superfuqisë e rolit të Rusisë në zhvillimet



botërore. Dhe momenti i situatës së grindur brenda perëndimit, shihet me interes të veçantë nga Putini, për të përfutur maksimalisht nga ky takim.

Mesazhi që është përcjellë nga Rusia, në prag të takimit është domethënës: se janë duke parë më shumë gjëra racionale në atë se çfarë Trump është duke bërë, por duke e shoqëruar me pohimin, se "ne nuk jemi naivë". Kuptohet, që një interes shumë të madh Rusia ka të cilohet apo të lehtësohet nga sanksionet e perëndimit, për vlerën e Rusisë ndaj aneksimit të Krimesë dhe shpërthimit të konfliktit në Lindje të Ukrainës, që kanë ndikuar ndjeshëm në ekonominë e Rusisë, por që për nevojat të stabilitetit të vendit dhe të pushimit, Putini është përpjekur t'i relativizojë ato. Natyrisht, që në këtë takim të rëndësishëm Trump-Putin do të diskutohet një tematikë e gjerë, ku vend të veçantë do të zërë edhe siguria e aleatëve evropianë, por edhe interesat ekonomike e gjeostrategjike të Rusisë në Europë, por edhe çështje të tjera sensitive si kriza siriane dhe e Lindjes së Mesme, çështjet e armëve bërthamore etj.

Natyrisht ky takim vlerësohet si një arritje e madhe për Putinin dhe Rusinë, se shpresohet që pas kësaj, SHBA as nuk do ta injorojë e as nuk do ta izolojë Rusinë. Ky takim i intereson jashtë mase Putinit edhe sa i përket pushtetit të tij në një situatë të brendshme ku ka dhe një problematikë konkrete ekonomike e sociale. Ky takim vlerësohet edhe si mundësi reale bashkëpunimi mes Rusisë dhe perëndimit, që mund të risjellë shpejt Rusinë në formatin e G8. Natyrisht që do të ketë ndryshime reale në marrëdhënien mes SHBA dhe Rusisë, të Rusisë me Europën, por disa çështje sensitive që lidhen me respektimin e ligjit ndërkombëtar të drejtën ndërkombëtare, që kanë prodhuar edhe sanksionet perëndimore, do të jenë një patate e nxehtë. Është fakt që në funksion të strategjisë së superfuqisë botërore Putini, përveç plotësim të standardeve të nevojshme

ekonomike, ushtarake, teknologjike e strategjike, aplikoi dhe strategjinë e shpërthimit të konflikteve të ngjira, ishte kashfikimi i Gjeorgjisë, që solli dy republika të vetëshpallura të Abkhasisë dhe Osetisë së Jugut, aneksimit e Krimesë dhe konfliktin në Lindje të Ukrainës, në rajonin e pasur të Dombasit, që do të jenë një patate e nxehtë në marrëdhënien e Rusisë me SHBA dhe Europën. Rusia, do të përpiqet të cilohet sa më shumë nga ky qëndrim i perëndimit të bashkuar, në të kaluarën, duke ofruar "argumente", por edhe duke e përdorur këtë situatë grindjeje brenda perëndimit, në favor të përçarjes së qëndrimit të perëndimit, me oferta konkrete të bashkëpunimit ekonomik me interes të veçantë për palët.

Në këtë moment nuk mund të mos tërheqë vëmendjen edhe kritika e presidentit Trump, ndaj Gjermanisë, lidhur me marrëveshjen për ndërtimin e gazsjellësit Nord Stream 2, për blerjen e sasive të mëdha gazi nga Rusia. Presidenti Trump ishte i drejtëpërdrejtë, kur foli hapur për vënie të Gjermanisë në vartësi të Rusisë. Presidenti Trump mendon se kjo marrëveshje demton çështjen e sigurisë. Në këtë kuadër ka dhe një deklaratë të ekspertes së sigurisë së energjisë në Këshillin e Atlantikut, Agnia Grigoris, që ka nënvizuar se gazsjellësi verior 2 bie ndesh me strategjinë zyrtare të BE për sigurinë dhe energjinë. Nëse ndërtohet ky gazsjellës, Gjermania do të ishte vendi i BE më i ekspozuar ndaj ndikimit të dyshmitë rus. Moska prej kohësh është mbështetur tek biznesi dhe ligjvënës gjermanë, për të përpunuar objektivat e veta strategjike – ka pohuar ajo. Madje sqaron se pas pushtimit të Krimesë nga Rusia, kompani të mëdha gjermane, në lidhje të konsiderueshme biznesi me Rusinë, ishin ndër kritikët më të ashpër të sanksioneve perëndimore ndaj Moskës.

Kancelaria Merkel i është përgjigjur këtij mendimi e kritike, duke theksuar se marrëveshjet e

energjisë me Rusinë nuk e bëjnë Berlinin e shekullit 21 rob të Moskës. Rusia nuk mund të mos ngazëllehët nga kjo grindje e retorikë brenda perëndimit, që do ta përdorë si trysni për lancimin e një politike e strategjike. Jo vetëm për të përfutur sa më shumë nga ky takim me presidentin Trump, por që i shërben Rusisë në shumë plane. Nuk mund të mos tërheqë vëmendjen në këtë prag takimi një deklaratë e ministrit të Jashtëm francez Le Drian, që flet për përpjekje amerikane për të destabilizuar BE. Ai arsyeton se presidenti Trump beson vetëm në marrëdhëniet konfliktuale, apo se përpiqet të shkatërrojë angazhimin multilateral të tregtinë, luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe kundër aktivitetëve bërthamore të Iranit. Ai deklarohej se Europa nuk do të lejojë veten të destabilizohet në asnjë mënyrë. Kjo retorikë realisht i vjen në ndihmë shumë Putinit në këtë takim të rëndësishëm me presidentin Trump. Presidenti Trump, ka pohuar në prag të takimit, se nuk dëshiron ta cilësojë Rusinë as si mik e as si armik, që i shërben, siç duket, të ketë një pozitë komode në bisedimet me Putinin. Megjithatë edhe Rusia, që ndjek nga afër zhvillimet brenda perëndimit, do të shfaqë strategji konkrete në marrëdhënien me SHBA, me synimin që të përfitojë sa më maksimalisht edhe në marrëdhënien me SHBA, por edhe në marrëdhënien me vendet evropiane.

Kjo rrethanë mund të favorizojë më shumë Putinin, aq më tepër që presidenti Trump realizon takimin, përveç një grindjeje me aleatët evropianë edhe me një luftë reale tregtare me Kinën, por dhe pas një takimi me Kim Jong Un, që deri më tash, nuk ka prodhuar ndonjë gjë konkrete me interes. Në një farë mënyre, me deklarimet dhe veprimet konkrete në funksion të filozofisë "America First", Trump ka dëshmuar pozitën dhe fuqinë e SHBA në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe me takimin me Putinin dëshmon se kërkon dialogun dhe jo konfrontimin, se kërkon bashkëpunimin me aktorët e rëndë-

sishëm ndërkombëtarë, për të mbrojtur interesat e SHBA dhe aleatëve të saj, por dhe për të përmbushur përgjegjësitë për sigurinë, paqen dhe stabilitetin në zhvillimin e sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo strategji e presidentit Trump mban parasysh edhe pasojat e ardhura nga një lloj tërheqjeje amerikane nga periudha e presidentit Obama, që realisht kanë rritur trysinë e Rusisë dhe Kinës ndaj SHBA për rivalitet e ndarje të fuqisë dhe rolit me të. Edhe me këtë takim me Putinin presidenti Trump kompletton pozicionin e SHBA në situatën aktuale në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, që udhëhiqet nga marrja e përgjegjësisë dhe përgjegjshmëria, konstruktiviteti, dialogu e bashkëpunimi. Kritika ndaj aleatëve ka brenda dhe nevojën për një angazhim e kontribut më të madh në të ardhmen e në kushtet e ndryshimeve reale në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku do të ketë tashmë edhe aktorë të tjerë të rëndësishëm. Këto zhvillime duhen kuptuar kështu edhe brenda kontekstit të pasurimit të mëtejshëm të përmbajtjes së modelit të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare, që ka nisur pas rënies së komunizmit. Në këtë rrugë duket se SHBA po rikonstrukturon përmbajtjen e rolit të saj në udhëheqjen botërore. Brenda këtij konteksti duhet kuptuar edhe deklaratat se SHBA nuk synon as injorimin e as izolimin e Rusisë. Ky ndryshim nënkupton edhe rishikimin, por edhe plotësimin e rregullave në funksion të zhvillimit të marrëdhënieve sa më të dobishme e konstruktive. Edhe Rusia nga ana e saj e ka imponuar një rol në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe nuk pret ndonjë dhuratë, por një vendosje të rregullave të dialogut e bashkëpunimit me SHBA. Ky element do të prevalojë në shtratin e marrëdhënieve mes SHBA dhe Rusisë, që realisht do të jenë të vështira. Natyrisht, përcjellja nga Rusia, përmes Lavrov e tezës, se kemi hyrë në një rend të ri post-perëndimor, ka elementin e evidentimit të ndryshimeve, por edhe të një trysnie reale ndaj SHBA, me interes pragmatik për të përfutur ar sa më shumë, që nga ky takim. Rezultate apo marrëveshje të rëndësishme konkrete nga ky takim i parë mes Trump dhe Putin edhe më optimistët nuk i mendojnë dot. Ky takim do të vlerësohet i rëndësishëm sepse shërben për të hapur rrugën e sendërtimit të një marrëdhënieje të re mes tyre, që do të ketë edhe kontradiktat, mosmarrëveshjet, por edhe marrëveshjet konkrete. SHBA ka në favor të saj, jo vetëm potencialin e mëdha konkrete komplekse, por edhe një rol e eksperiençë shumë të pasur në udhëheqjen e zhvillimeve botërore, ndërsa Rusia do të përpiqet të përfitojë sa më shumë edhe nga grindja brenda perëndimit. Ka një problematikë të hapur mes tyre, por që do të pasurohet edhe nga zhvillimet në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Natyrisht, që mund të gjendet mundësia edhe e nënshkrimit të ndonjë marrëveshjeje mes tyre në këtë takim, ku mendohet të jetë çështja e shtyrjes së afatit të traktatit bërthamor New Start, që ka hyrë në fuqi në vitin 2011 dhe që përfundon në vitin 2021. Nga interes nga të dy palët për ta shtyrë afatin e këtij traktati, të pakten edhe për pesë vjet të tjera, sepse u krijon të dy palëve më shumë transparencë. Edhe pse presidenti Trump e ka vlerësuar më parë këtë marrëveshje, të keqnegociuar nga ish-presidenti Obama, mendohet se do të mundësohet një dakordësim për shtyrjen e afatit. Megjithatë, zhvillimi i këtij takimi mund të vlerësohet vetëm pozitivisht, sepse i shërben dialogut dhe bashkëpunimit më interes të sigurisë, stabilitetit dhe paqes në botë.

Më 15 korrik 2018



Opinioni Ditës

# Të kontrollosh burimin: Studimet më interesante në median digjitale gjatë 2018

Nga MONIKA STAFIA

(vijon nga faqja 1)

... Journalist's Resource, quhet qendra e cila mban rrotull vetes një grup profesionistësh ku së bashku vendosën të krijonin një faqe interneti me qëllimin për të informuar gazetarët mbi studimet më të fundit akademike. Ky është një projekt i Qendrës Shorenstein mbi mediat, politikën dhe të mirat publike në Shkollën e Qeverisjes John F. Kennedy të Universitetit të Harvardit. Në këtë faqe përmbledhen çështjet më të rëndësishme të trajtuara nga studiues të ndryshëm, shkruar në një stil gazetaresk, dhe fokusuar kryesisht të historia e subjektivit. Ky projekt nisi në vitin 2010, fillimisht për ta bërë më të lehtë për profesorët e gazetarisë që të japin mësim rreth raportimit të studimeve akademike. Duke hulumtuar në këtë faqe do të shohim më poshtë se cilat janë ato çështje studimore, të evidentuara si më të mprehtat e kohës së sotme, epokës digjitale dhe gazetarinë. Artikujt janë shkruar së fundmi dhe publikohet online prej tre muajsh. Qëllimi ynë është të evidentojmë me hapat e kohës cilat janë pikat kryesore në të cilat ndërtohet sot një gazetari moderne dhe një media, e cila po rreshtet prej standardeve të saj profesionale. Zhvillimi teknologjik ka rrezikuar parimet kryesore të gazetarisë dhe punës së gazetarit. I sjellim sot të pasqyruara konkretisht e shkurtimisht disa nga top-diskutimet më të nxehta më rreth e botës akademike në fushën e komunikimit dhe gazetarisë. Studimi i parë titullohet: “Kur qytetarët dhe gazetaret ndërveprojnë në Twitter” (Pritshëmerië e performancës së gazetareve në mediat sociale dhe perceptimet e paragjykuara të medias). Mjaft raporte përgjatë viteve kanë theksuar vazhdimisht problemet që hasen në mediat, të cilat duheshin lajme, sa i takon sidomos besueshmërisë së publikut. Studiuesit janë kureshtarë se si kjo marrëdhënie mund të ndryshojë ndërsa gazetaret gjithnjë e më shumë mbështeten në platformat e medive sociale për të mbledhur informacionin, për të ndërvepruar me publikun dhe për të promovuar punën e tyre. Në shumë mënyra, këto platforma ofrojnë një dritare të hapur në procesin e raportimit. Ata, gjithashtu, e lejojnë publikun të dëshmojë besëda me gazetareve dhe njerëzve, të cilët ata i intervistojnë, pra dialogun mes tyre, dialog që interpretohet në mënyra të ndryshme. Ky material ka përqendrim të vlerësues se si mediat sociale ndikojnë në perceptimet publike të gazetareve. Studiuesit kanë analizuar të dhënat e sondazhit të kryer në SHBA me qëllimin për të zbuluar se çfarë njerëzit presin prej përdorimit të medias sociale nga gazetaret dhe cilat janë më shumë mundësitë të angazhohet me gazetaret në Twitter. Ata, gjithashtu, konsideruan faktin se si këta dy faktorë mund të influencojnë në sensibilizimin e dikujt rreth anshëmerisë së medias. Po çfarë gjetën autorët e gjatë kërkimeve? Njerëzit, të cilët presin që gazetaret të përdorin mediat sociale pozitivisht; q.d.m.th., ata nxisin besëda që ndihmojnë në kontekstualizimin e historive, pikërisht këta kanë më shumë gjasa të bashkëveprojnë në Twitter. Ndër të tjera studimi ka sugjeruar se përvojta në mediat sociale përcaktojnë dhe standardet për një lloj reciprociteti midis gazetareve dhe audiencës së tyre. Në përgjithësi, një marrëdhënie më e afërt me gazetaret në Twitter



shoqërohet me nivele më të ulëta të paragjykimave të perceptuara prej mediave.

Studiimi tjetër me titullin “Investigimi i burimit politik në Twitter: Kur korrigjimet kanë një efekt”, është një studim që ka ngjallur shumë diskutime. Deri më sot, hulumtimet mbi përhapjen e lajmeve të rreme dhe jo korrekte tregojnë se ato janë të vështira për t'u ndaluar dhe se në rrethanat e caktuara, njerëzit që kanë frikë nga e vërteta do të mbahen akoma dhe më fort tek lajmet e rreme. Ky kërkim i ri studimor, hedh dritë mbi atë se si raportet me rrjetet sociale mund të ndihmojnë në frenimin e rrjedhjes së informacionit të gabuar. Këta hulumtues kanë kryer dy studime, nëpërmjet të cilëve është parë se si përdoruesit e Twitter-it kanë korrigjuar njëri-tjetrin. Gjatë studimit të parë, ekipi ka analizuar postimet në Twitter vendosur që nga mesi i janarit në vitin 2012 deri në prill të vitit 2014. Postimet u dërguan në përgjigje të një përdoruesi, i cili kishte bërë një deklaratë të gabuar në lidhje me politikën e SHBA-së. Kërkuesit u përqendruan në mënyrën se si njerëzit reagojnë ndaj përgjigjeve që morën në Twitter, e që më së shumti theksonin gabimin duke iu referuar një prej tri faqeve të internetit që merret me investigimin e fakteve.

Në studimin e dytë, studiuesit kërkimin e përqendruan sërish në këtë platformë, pra në Twitter. Periudha e përcaktuar ishte 31 tetor 2015 dhe 3 shkurt 2016. Referencat shkonin për Snopes.com, një veb-sajt që punon për kontrollin e burimit të vërtetë. Përsëri, ata shqyrtuan ndërveprimet mes përdoruesve të Twitter-it që bënë deklaratat të pasakta dhe ata që vinin në dukje gabimet. Këtë herë, kërkuesit i krahasuan përgjigjet e përdoruesve bazuar mbi faktin nëse deklaratat e pasaktë, lidhej me politikën e SHBA-së apo me ndonjë subjekt tjetër. Rezultatet, treguan se përdoruesit e Twitter-it kanë më shumë gjasa të pranojnë korrigjime nga miqtë dhe individët që i ndjekin ata. Ndërsa më pak të ngjarje, kanë të pranojnë korrigjime ndaj një gabimi që lidhet me politikën sesa një tjetër temë.

I treti studim mban titullin “Shkenca e lajmit të rremë”.

Në të, një grup akademikësh me profil të lartë nga një sërë fushash ofruan një strategji për të kuptuar më mirë lajmin e rremë, për të parandaluar shpërndarjen dhe ndikimin e tij. Grupi përshkruante shkurtimisht, atë që deri tani njihesi si pjesë e sfida të ndalimit të lajmit të rremë dhe kufizimeve të kontrol-

lit të fakteve. Ata u fokusuan kryesisht në dy lloje të ndërhyrjes: së pari, duke i ndihmuar njerëzit të njohin më mirë lajmin e rremë kur e shohin atë. Mandet të bëjnë ndryshime strukturore, të cilat zvogëlojnë ekspozimin e publikut ndaj përmbajtjeve jo të vërteta. Artikulli mbetet në thelb një thirrje për veprim, duke i bërë thirrje platformave të internetit dhe mediave sociale të punojnë me studiuesit për të vlerësuar problemin, për të programuar apo testuar ndërhyrjet. “Ka pak hulumtime të fokusuara tek lajmi e rreme dhe ende nuk ka një sistem gjithëpërfshirës për grumbullimin e të dhënave për të përfutur nga marrëdhënjet dinamike mbi saktësinë e tyre. Ndërsa teknologjia avancuan në evolucionin e saj, sisteme të tilla të ofrimin të lajmeve të rreme janë duke u zhvilluar”, shkruajnë autorët.

U treti studim quhet “Ekspozimi selektiv ndaj dezinformimit: Raste prej konsumimit të lajmeve të rreme gjatë fushatës presidenciale të vitit 2016 në SHBA”.

Duke folur për lajmet e rreme, ne ende nuk jemi në gjendje të njohim ata, të cilët i duan këto lajme apo kategoritë që ata zgjedhin t'i publikojnë, pra ata individë, të cilët ndërtojnë shpesh faqe interneti kryesisht me lajme të rreme. Ky lloj studimi, ofron informacione të reja për të dyja frontet. Janë tre akademikë, Andrew Guess, Brendan Nyhan dhe Jason Reifer, ata të cilët shqyrtuan dy burime të dhënash: i pari, i cili është bazuar në rezultatet e një studimi online të marrë nga një kampion kombëtar, përbërë nga 2,525 amerikanë dhe i dyti, i cili u bazua në të dhënat që u mbledhën prej trafikut të internetit të grumbulluara nga kompjuterët e tyre, në javët para dhe menjëherë pas zgjedhjeve të vitit 2016. Studiimi i tyre solli një grup detajesh mjaft interesante. P.sh., një në katër persona të rriturish, e vizitonin një faqe interneti me lajme të rreme, shumica ishin mbështetës të Donald Trump dhe kërkoni përmbajtje lajmesh pro-Trump. Rreth 15% e mbështetësve të Hillari Klintonit, lexonin të paktën një artikull nga një faqe interneti me lajme pro-Klinton. Interesante ishte se gjetjet sugjeronin që “konsumi i lajmeve të rreme duket të jetë një plotësim më shumë se një zëvendësim i një lajmi të besueshëm apo jo. Pra, leximi i këtyre lajmeve prej faqeve që përhapin fake news, nuk ndikon për të dhënë më shumë shpjegime për lajmet më të rëndësishme të ditës. Vizita, sipas studimit, në faqet e lajmeve të rreme janë më të lartat në mesin e njerëzve që konsumojnë lajme të rëndësishme të ditës dhe nuk zvogëlohen në mënyrë të matshme në

mesin e individëve më të informuar politikisht. Po ndërkohe çfarë bëhet në lidhje me përpjekjet për kontrollimin e fakteve? A kanë arritur të shkojnë deri tek konsumatorët e lajmeve të rreme? Mbështetërit në këtë studim, pohohet se kjo gjë nuk është mundur të arrihet ende.

Studiimi i katërt: “Populizmi, gazetaria dhe kufijtë e reflektivitetit: rasti i Donald J. Trump”.

Akademikët dhe gazetaret kanë vlerësime të ndryshme për rolin që luajti media në mbërritjen e Donald Trumpit në presidencën amerikane. Ky punim ofron njohuri të rëndësishme dhe interesante në atë se si gazetaret vlerësojnë punën dhe gabimet e tyre për këtë çështje. Autorët shkruajnë se është e rrezikshme të pranosh se si gazetaret kanë kontributun e tyre parësor në suksesin e Trump. Michael McDevitt dhe Patrick Ferrucci janë profesorët, të cilët udhëhoqën një analizë tekstuale duke krahasuar diskutimin e studiuesve dhe profesionistëve të lajmeve në ditët postzgjedhore të vitit 2016. Ata analizuan komentet e 86 akademikëve të cilët kontribuan në një vëllim të titulluar: “Analiza zgjedhore në SHBA vitit 2016: Media, votuesit dhe fushata elektorale”, realizuar nga Universiteti Bourneimouth në Mbretërinë e Bashkuar. Ata, gjithashtu, shqyrtuan 212 artikuj të botuar në gazetaret kryesore të vendit, të cilat kishin diskutuar rolin e shtypit në zgjedhje. Gazetaret dhe kolumnistët argumentuan se një mori faktorësh kontribuan në suksesin e Trump, ndërkohe që akademikët në masë të madhe këtë sukses ia kredituan plotësisht mediave.

Gjatë diskutimit gazetesark është pohuar se fitorja e Trump ndodhi për shkak të analfabetizimit mediatic të publikut; shumimi të mediave sociale, të cilat përhapnin lajmin e rremë dhe lejimin e fluskaeve të pafiltruara; dhe në fund dështimi i shtypit për të kuptuar thellësinë e zemërimit të votuesve. Studiuesit e shikonin ngritjen e Trump si të parashikueshëm, duke njohur anësitë politiko-historike të shtypit; keqkuptimet e gazetareve mbi termin “publik” dhe “populizim” si dhe kushtet e skajshme ekonomike në të cilat bëhet sot gazetaria.

Studiimi i pestë: Audiencia e kuantifikuar në prodhimin e lajmeve: Një sintezë dhe axhendë kërkimore. Ky studim shqyrton se si fokusi në ritje të redaksive në thithjen e audiencës ka ndikuar në prodhimin e lajmeve. Rodrigo Zamith shqyrtoi ndikimet në pesë fusha kryesore duke përfshirë përmbajtjen e lajmeve, etikën e media dhe sjelljen e mirë në redaksi. Ai sugjeron se po hijjmë në një valë të tre të racionalizimit të asaj çfarë publiku do, si një vazhdim i shtyesave që kanë nisur që në vitet 1930 dhe 1970; përdorimi i metodave shkencore dhe inovacionet teknologjike janë ato që du mund të përcaktojnë më mirë preferencat dhe sjelljen e audiencës. Prof. Zamith, gjithashtu, ka ngritur ndër të tjera edhe shumë pyetje, të cilat studiuesit ende nuk i përgjigjen p.sh., gazetaret që mbështeten më shumë në analiza, a e shohin audiencën e tyre më pak apo më shumë inteligjente, pjesëmarrëse, racionale, të arsyeshme apo të zhytur në mendime? Të gjitha këto detaje analitike dhe shumë pikëpyetje sa e përkeqëzojnë më shumë se sa i përkeqëzojnë më shumë duke i shtuar mund të mesojmë më shumë duke iu referuar bazave të saj në vitet 30-70 janë pikërisht këto hulumtime anketore shkencore që do të mund të na laborojnë më tepër njohuritë mbi këtë fushë.

### HOROSKOPI

#### DASHI

Nuk do kërkoni asgjë tjetër sot përveç qëndrueshmërisë në jetën tuaj në çift. Nëse flisni qetësisht me partnerin do i sqaroni mosmarrëveshjet dhe do jeni më të qetë. Puna e vazhdueshme e gjithë këtyre muajve do bëjë që të keni një ritje të konsiderueshme të financave.

#### DEMI

Jeta në çift nuk do jetë aspak e mirë gjatë kësaj dite. Do keni debate të shumta me partnerin dhe nuk do ndiheni rehat pranë tij. Flisni dhe shprehni gjithçka, sepse çekullibrimi juaj mund të ndikojë dhe në financat së fundmi.

#### BINJAKET

Do jeni shumë të zënë me zgjidhjen e një problemi familjar, nuk do i kushtoni rëndësi dhe duhur atij që keni në krah. Shpjegojani si është situata nëse nuk doni që ai të mërzitet. Mundohuni të gjeni kohë për gjithçka.

#### GAFORJA

Pritet që dita e sotme të jetë shumë e qetë për të dashuruarit. Bashkëpunimi dhe komunikimi do jetë i mirë e nuk do përbëjë asnjë problem. Në planin financiar nuk duhet të luani shumë me shpenzimet.

#### LUANI

Dashuria do e bëjë edhe më të bukur ditën sot. Do kaloni momente mjaft emocionuese pranë atij që dashuron dhe nuk do doni të ndaheni për asnjë moment nga ai. Planifikoni një udhëtim sepse financat duken të jenë mirë.

#### VIRGJERESHA

Do e keni paksa të vështirë sot t'i qëndroni besnik personit që keni në krah. Do kërkoni më tepër liri, por kur ta humbni partnerin do ndiheni bosh. Mos u nxitoni! Kujdes me financat.

#### PESHORJA

Jeta sentimentale e çifteve do jetë e mbrojtur gjatë kësaj dite. Do keni më shumë besim tek tjetri dhe gjithashtu do respektini mendimet e tij. Në planin financiar nuk ka ardhur ende momenti për të filluar shpenzime të mëdha.

#### AKREPI

Për të qenë të lumtur me partnerin duhet të bëni disa lëshime të vogla. Mos kërkoni gjithmonë të të dalë e juaja sepse do keni mosmarrëveshje. Financat nga ana tjetër do jenë të stabilizuara.

#### SHIGJETARI

Ata që janë në një lidhje do kenë surprizë të këndshme gjatë gjithë ditës. Partneri do ua bëjë qejfin për gjithçka, prandaj shfrytëzoni çdo moment. Mos shpenzoni pa menduar sa e keni buxhetin.

#### BRICJAPI

Ambienti në çift do jetë shumë i ngrohtë gjatë kësaj dite. Do kaloni më shumë kohë pranë atij që dashuron dhe do i shprehni më tepër ndjenjat. Financat do kenë përmirësime të ndjeshme.

#### UJORI

Ata që janë çift më në fund do jenë të lumtur. Bashkëpunimi dhe komunikimi do mbizotërojë gjatë gjithë kohës. Në mbremje prita disa momente që nuk i keni menduar më parë. Financat janë duke u stabilizuar.

#### PESHQIT

Do jeni më tepër xhelozë sesa duhet sot dhe kjo mund të sjellë mosmarrëveshje me partnerin. Mos e tregoni, sepse çdo gjë e ka një kufi. Lëreni partnerin të shpjegohet.

ÇMIMET E BOTËRORIT



Për herë të dytë në histori Franca shpallet kampione bote, por ky nuk ishte i vetmi trofe që "gjelat" marrin më vete. Pa asnjë diskutim Kilian Mbape shpallet lojtar i ri më i mirë i Botërorit. Talenti i PSG-së vijon në gjurmët e legendës braziliane Pele, fillimisht me dy golëshin kundër Argentinës u bë futbollisti i dytë nën 20 vjeç që

Modrić më i miri, Kejni goleador

shënonte një dy golësh në një ndeshje me eliminim direkt, ndërsa në finale u bë futbollisti i dytë nën 20 vjeç që shënonte gol. Mbape kurorizohet në këtë mënyrë një botëror perfekt. Kroacia nuk arriti të bënte historinë, por sigurisht që largohet me kokën lart nga ky

Botëror. Ballkanasit ishin një shembull frymëzimi, një Kombëtare e vogël që bëri të madhen në "Rusi 2018". Kapiteni dhe lideri i tyre Luka Modrić u shpall në përfundim të turneut lojtar më i mirë i Botërorit. 2 gola brenda 90 minuta dhe dy penallti të sakta pas kohës shtesë.

Modrić ishte jo vetëm lojtari më përcaktues në këtë aventurë historikë të Kroacisë, por dhe lojtari më i mirë i Botërorit. Anglia nuk arriti të kthehej me Kupën në shtëpi, por Herri Kejn arrin të fitojë trofeun "Këpuca e Artë". Kapiteni i tre luanëve me 6 gola të shënuar u shpall golashënuesi më i mirë i

Botërorit. Belgjika ishte skuadra me sulmuese e këtij botërori, por në formacion "djajtë e kuq" ishte një portier si Tibo Kurtua, i cili u shpall portieri më i mirë i këtij botërori. U eliminuan më shumë zhurmë, por Spanja ishte një nga përfaqësuar model të këtij botërori duke marrë gminim Fair-Play.

4-2 për "gjelat" dhe Kupa shkon në Paris. Dëshamp arrin Bekenbauerin dhe Zagallon

Jeton Selimi

# Franca kampione e botës, Kroacisë s'i mbajnë këmbët!

## Kilian Mbape eklipson Luka Modrić



**F**ranca Kampione Bote! Franca shkruan një tjetër faqe të historisë së saj! Triumfi ndaj Kroacisë vjen ekzaktesisht 20 vjet pas titullit të parë botëror. Në "Luzhnik" të Moskës "gjelat" e Dëshamp fitojnë 4-2 mbase finalen më të bukur të të gjitha kohërave. 6 gola, emocione, autgola dhe penallti, një sukses që shkon për trikoloret e Dëshamp, me Didier Drogba në "Hall of Fame", i treti në tavolinën e të mëdhenjve, ku më herët ishin ulur Franc Bekenbauer dhe Mario Zagallo, të vetmit që para Dëshamp e kishin shijuar suksesin e madh qoftë si lojtar e qoftë si trajner. Fjalët më të mira për Zlatko Dalić dhe djemtë e tij. Ata historinë e kishin bërë ende pa e luajtur finale, ndërsa në 90 minutëshin e Moskës vuajtën ngarkesën e madhe të fushatës ruse, pasi gjatë eliminatoreve luajtën tri takime radhazi në shtesë, ndërsa Franca në këtë aspekt ishte më e freskët. Por pavarësisht kësaj janë ballkanasit ata që e nisnin më mirë ndeshjen, kërkojnë dhe gjejnë vertikalizime, por nuk kërcojnë seriozisht portën e Loris. Nga ana tjetër, Franca ka shumë fat pasi në harkimin e parë në zonë, Manxukiç devijon padashur në portën e tij, duke u dhënë epërsinë "gjelave". Pa fat Mario, që realizon autogolin e parë në histori në një finale botërori, ndërsa në këtë edicion ishte autogoli i 29-të. Gjithsesi Kroacia nuk heq dorë nga sulmet e saj dhe do të barazojë shpejt. Perisic shërbehet në zonë dhe me të djathtën rikthen baraspeshën. Ballkanasit vijnë të këmbëngulin, por ndëshkohen nga një tjetër episod. Harkim në zonë nga këndorja dhe Perisic devijon me dorë. Argentinasi Pitana fillimisht jep rivite fundore, por pas ndërhyrjes së VAR-it, akordon penallti për transalpinët, të cilën e kthen në gol Antuan Grizman. Pavarësisht këmbën-

guljes së Kroacisë, pjesa e parë do të mbyllet me fitoren 2-1 të Francës. Edhe pjesa e dytë është një fotokopje e së parës. Kroacia është ajo që nis manovrën

offensive në kërkim të barazimit, por golin e shënon Franca. Aksion i shpejtë i "gjelave" me topin që shkon te Pogba, i cili këmbëngul dy herë, por arrin të

thyejë Subasiçin. 3-1 dhe Franca kupton se kupa ka marrë rrugën për në Paris, aq më tepër kur Kilian Mbape tund rrjetën për herë të katërt, një gol i sh-

këlqyer i 19-vjeçarit, që bëhet adoleshenti i dytë që shënon në një finale botërori, ai tjetri është njëherë Pele! Dalić e kupton se Kroacia e tij nuk ka më se çfarë të bëjë. Fundja mrekullitë nuk zgjasin përgjithnjë, ndonëse Loris me një gafë u dhuron kroatëve një shpresë të vakët, shpresë që zbehet me kalimin e minutave, derisa fiket fare kur Nestor Pitana vërshëllon tre herë dhe bën që Franca të sigurojë Kupën e Botës pas një fushate ruse të ashpër, ku të mëdhatë u eliminuan njëra pas tjetrës. Kampione e dyfishtë ashtu si Argjentina. Franca e gjeneral Dëshampit ia doli, një strateg që edhe Bonaparti do ta kishte zili!

Trajneri i Francës




**Dëshamp: Nuk bëme një ndeshje të madhe, por e merituar**

Në intervistën menjëherë pasi u shpall kampion i botës, trajneri i Francës, Didi Dëshamp, e pranoi se ekipi i tij nuk bëri një paraqitje të madhe, por ai lavdëroi pa masë punën e djemve të tij. "Është një ndeshje kaq e bukur. Disa prej kampionëve janë vetëm 19 vjeç. Nuk bëme ndonjë ndeshje të madhe, por treguam kualitetet tona. Shënuam 4 gola, dhe them se e merituar. 2 vite më parë na dhëmbi shumë humbja në Europian, dhe nuk ishte e lehtë të ringriheshim. Por, tani jemi në çatinë e botës, dhe tani ndihemi shumë mirë. Ky moment i përket vetëm lojtarëve. Për 55 ditë, kemi bërë shumë punë. Jemi krenarë që jemi francezë!" - deklaroi Dëshamp.

SULMUESI

Grizman në qiellin e shtatë: Sot do fle me Kupën e Botës

**A**ntuan Grizman u shpall lojtari i ndeshjes finale të Kupës së Botës. Lojtari krijoi golin e parë ku hodhi një krosim të rrezikshëm në zonë dhe Manxukiç bën autogol. Lojtari i Atletiko Madridit ka shënuar edhe një gol me penallti. Ndërkohë ai ka dhënë dhe një deklaratë pas ndeshjes. "Nuk e di ku jam. Jam vërtetë shumë i lumtur. Ishte një ndeshje shumë e vështirë. Kroacia zhvilloi një paraqitje të madhe. Ne e ulëm pak ritmin kur u barazuam, por në fund ia dolëm të bënim diferencën. Me zor po presim që ta çojmë Kupën e Botës në Francë. Tek penalltia, hezitova të bëja "panenkan", ashtu si Zidan më parë. Preferova më mirë që të hap këmbën dhe të gjuaj. Sot do të fle unë me Kupën e Botës." - u shpreh Grizman pas ndeshjes.



Trajneri do të marrë 2 milionë dollarë

Argjentina shkarkon Horge Sampaolin


**I**shte në ajër që prej ditës së eliminimit nga Botërori, kur Franca e mposhti Argjentinën me rezultatin 4-3. Mbetej vetëm të gjendej gjuha e përbashkët në aspektin ekonomik. Një akord që ka mbërritur natën vonë, duke i dhënë fund aventurës së Horge Sampaolit në stolin "albiseleste". Federata ka arritur një pikë dakordësie me avokatët e trajnerit, që do të përfitojë 2 milionë dollarë në total për shkarkimin e menjëherëshëm. Pavarësisht konfirmimit të pak ditëve më parë pas takimit kokë me kokë të Sampaolit dhe presidentit të federatës Klaudio Tapia, AFA i ka dhënë quart trajnerit që e sollti në krye të skuadrës vetëm një vit më

parë dhe me një kontratë të gjatë deri në vitin 2022. Sampaoli zbaroi në stolin e "La Selecion" më 1 qershor të vitit të shkuar mes skepticizmit të mediave dhe tifozëve, ndonëse kishte fituar një Kopa Amerika në krye të Kilit. Dhe pas flopit në këtë botëror, fati i tij ishte i shkruar. Aventura në krye të Argjentinës u mbyll me një bilanc prej 7 fitoresh, 4 barazimesh dhe 4 humbesh, mes të cilave spikat humbja 6-1 me Spanjën dhe ato ndaj Rusisë, Kroacisë dhe Francës. Tani në Argjentinë kanë ni-

sur zërat e parë për zëvendësimin, ndërsa kandidatë ka shumë. Një sondazh i kryer nga e përditshmja argjentinase "Ole", në të cilin kanë marrë pjesë 220 mijë tifozë, thotë se i preferuari i tyre është Diego Simone me 33% të votive dhe më pas vjen Gajardo me 29%. Shumë larg gjendet Gareka me 13% dhe Poketino me 11%. Kruga më e thjeshtë për momentin është ajo që të çon te "Tigri" Gareka, që është i lirë pasi dorëzoi stolin e Perusë pas përfundimit të fazës së grupeve në Botëror.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Riza aktor.
- Një fjalë si hiç.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premton të bëhet as.
- Janë felinë... të zinj.
- Ami i Maupassant.
- Heroi i Emilio Salgarit.
- Oe anarkist i famshëm rus
- Një mungesë gjaku.
- Susanna shkrimtare
- Të parat në cilësi.
- Mbyllin një shtëpi.
- Mbeten në fund.
- Qendër në kaos.
- Ka brrirë piktoreskë një i tillë
- Inicialet e Camus.
- Motra... e Kolë Idromenos
- Një konfuzion total.
- Rastet pa set.
- Rastisin në krye.

- Fillojnë detyrën.
- Bektashi këngëtare.
- Andrea aktore.
- Sampras i tenisit.
- Shkroi Korbi (indic).
- Triolet e Trëndafilë me kredi.
- Kilmer aktor.
- Në krye të robotëve.
- Unë dhe ti.
- Një mund të jetë fetar.
- Stephane poet francez

**VERTIKAL**

- Fillojnë praktikën.
- Britma e Arkimedit.
- Ekstreme në trap.
- Në fund të fundit.
- Janë fjetoret e ushtarëve
- Parker regjisor.
- Vivaldi kompozitor.
- Një shkop për karambol.
- Janë firmat rentiere.
- Një i fundit mbi të gjithë
- Kufizojnë tatimet
- Janë nomadë.
- Panik pa kufij.
- Fryn detin
- Sidney regjisor i Serpico.
- Jep alarmin.
- Fillojnë nazet.
- Janë llogari.
- Alan regjisor.
- Roman regjisor.
- Eshtë X ajo e sulmit.
- Kapen të parat.
- Një provë... inteligjence.
- Një markë lap top.
- Fillojnë matjet.
- Ruga e Ferenc Molnar.
- Qerre pa qe.
- Fillojnë lirinë.
- Fillojnë vallen.
- Në mes të dhomës.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Një doktor... i Fritz Lang
- U paraprinë hoteleve.
- Kush nuk ka... nuk ha
- Eshtë djall
- Një mund të ketë i rralle.
- Ishin perëndi të Samotrakias.
- Institucione Botuese Autonome.
- Eshtë infeksion në bark
- Fundi i një samurai.
- Një markë kafeje.
- Mbyllin një hark.
- Mund të jetë emërore.
- Ishte muzikanti që nuk përsiste.
- Në krye të avokatëve.
- Qerre pa qe.
- Një pjesë e adoleshentëve.
- Një banor imagjinar i planetit të kuq.
- Nuk shuhej dot nga Tantalit.

**VERTIKAL**


- James, armiku i Sherlock Holmes.
- Eshtë edhe ajo saudite.
- Imami aktore
- I kanë çift turket.
- Inicialet e Seagal aktor.
- Eshtë dëshmore... çudibërëse.
- Në fund të lutjes.
- Eshtë sporti me stil të lirë.
- Mbeten në fund.
- Eshtë rasti i veçantë, karakteristik.
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Gjysmë ditari.
- Mario, që qe bomber argjentinas.
- Mund të prishej nga një... kleçkë.
- Në hyrje të pistës.
- Një numër... femrash.
- Eshtë qyteti i Besës.
- Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- Njëlotj për latinët.
- Mund të bëjnë stil të lirë.
- Damon aktor.
- Eshtë pije e jona.
- Në krye të noterëve.
- Film i Robert Altman.
- Skuadra merengue.
- Një pjesë e hasmërisë.
- Rralle është përgjysmë.
- Nisur pa kufij.
- Fillojnë mobilizimin.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

4								7	
	3			9				2	4
			2				1		5
		9							6
		8	7	2					
	1		4	6	5				
		4							3
	8	6				9			
	5			7	6				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

4	1	6	2	3	8	5	7	9
5	3	8	7	4	9	1	6	2
2	7	9	5	1	6	3	4	8
6	8	1	3	2	7	9	5	4
7	9	4	8	5	1	2	3	6
3	5	2	9	6	4	7	8	1
9	6	3	4	7	2	8	1	5
1	2	5	6	8	3	4	9	7
8	4	7	1	9	5	6	2	3

*Argëtim filozofik*

- Nëse një ditë do të më kërkosh dhe nuk do të ekzistoj më... vetëm mos harro se dikur isha atje për ty ... dhe ti nuk dite të më vlerësosh .
- Por do të vijë çasti kur vetmia do të të lodhë, kur krenaria jote do të përkeulet dhe guximi yt do të dërmohet.
- Atëherë do të bërtasësh "Jam vetëm".
- Gjërë më të bukura në jetë nuk i shohim me sy ... por i ndiejmë me zemër !!!

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2		1	11	2	7	I	R	S	E	R	B	B	I	D	E	T		
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2	B	E	L	A	M	I	S		R	N	I		
		1	12	4	2	12	4	11		6	1	8	I	I	H	I	P	O	T	E	Z	A	T		
4	11	2				5	10	3	1	15		12	2	Z	P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T
7	4	12												A	N	E	T	A	R	E	T	L	A	A	
3				5	10	3	1	14	4	6	1			A	R	I	T	I	U	I	T	A			
4	12	2			5	1	7	2	12		11	4	3	A	T	E	E	M	T	A	I	R	O		
7	10	6	10			14	4	8		12	10	7	4	K	E	N	E	T	E	I	T	A	K	A	
12	11	1			9	4		12	6		8	15	8	T	K	D		T	E	A	N	T	A		
1	12		12	15	12	15			1	12	1		14	U	N	I	O	N	M	R		T	K		
7	2	14	4	12			7	K	O	S	H		3	A	I	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T
4	12	1	7			9	4	7	9	4	11	4	12	L	K	S	T	U	R	I	S	T	E	T	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

M A R I E S K O H A A K  
F I L L I D O M A T E R  
R A F I T M I M R S E  
N H P A K K E T M E T T I  
Z E M E R A K E T M E T T I  
F I D A N E T V E T E M  
S E N A T I I B E R I K E  
S E N E K A L L A P A T  
T R E E L S A I T  
L I V E T A K A A D  
N A A R N J E A P E L

**FJALËKRYQI (2)**

D A L A I V A K A N T E  
E D E N P N A D I A M  
R R E M I R E T T R I O  
T E S T R T A T E O L  
K S M N O T A R E T N L  
K A M E R I K A N E  
E H P A M A D S H  
K O L O N A G T E C E  
T U N E L E T E R O S  
O R A I T K A S T I A P  
K A N S A R A H E P  
E T J A C I T A T E T I



*Thënie të mençura*

- Përpjekja për të sjellë parajsën në tokë, udhëheq pa përjashtim, në ferr.
- Kënaqësia më e madhe në natyrë, është mungesa e njerëzve.
- Kur ju mendoni atë që keni humbur, ju humbni atë që jetoni.
- \*Ta zemë se ajo më do, sa shumë do të më merzisë në këtë rast. Dhe, ta zemë se nuk më do, sa shumë arsye më të mëdha akoma do të kishte në këtë rast që ajo të më bëhet e mërzitshme! -Pra, nuk paska veçse dy mënyra për t'u mërzitur: kështu që, le të marthemi.

